





AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në “Asistent Social”
i Institucionit të Arsimit të Lartë
Kolegji Universitar “Wisdom”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Phd. Eglantina Dervishi 
2. Dr. Darina Çoni (Kacollja) 

Shtator/2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: 2 vjeçar me karakter profesional në “Asistent Social”, ofuruar nga Kolegji Universitar “WISDOM”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “WISDOM”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi 2 vjeçar me karakter profesional në “Asistent Social”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 367, datë 05.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	12
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Wisdom", ish Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" është krijuar nga shoqëria "Wisdom" sh.p.k. mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 672, datë 27.09.2006. Me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.02.2008, është dhënë leja për zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë dhe atë të Psikologjisë. Me Urdhër Nr. 412 datë 25.08.2011 të MASR është miratuar riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" me dy fakultete, Fakulteti i Drejtësisë me tre njësi bazë: Departamenti i së Drejtës Publike, Departamenti i së Drejtës Private, Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike e Shoqërore, me tre njësi bazë: Departamenti i Ekonomisë, Departamenti i Psikologjisë, Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Institucioni është akredituar me kusht me Urdhër Nr. 355 datë 25.09.2015, kushte të cilat janë plotësuar me Urdhër të MAS Nr. 237, datë 09.05.2016 si dhe është riakredituar me VBA Nr. 103 datë 10.11.2017, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe afat vlefshmërie deri më 09.11.2020. Mbështetur në nenin 20, 33 dhe 129 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik me Vendimin Nr. 6, datë 03.02.2017 vendosi riorganizimin e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" në Kolegjin Universitar, me emërtimin Kolegji Universitar "Wisdom". Njësia bazë që ofron programin e studimit me karakter profesional "Asistent Social" është Departamenti i Psikologjisë, pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike e Shoqërore. Programi i studimit me karakter profesional "Asistent Social" është licensuar me Urdhër të MASR. Nr. 367, datë 05.07.2018. Programi i studimit me karakter profesional në "Asistent Social" realizohet me 120 kredite (ECTS), në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në gjuhën shqipe, e në përfundim të tij lëshohet diplomë profesionale në "Asistent Social". Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, ku si pjesë e të cilit është provimi i përgjithshëm përfundimtar. Numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit me karakter profesional "Asistent Social" për vitin akademik 2019-2020 është 12.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit 2 vjeçar me karakter profesional në “Asistent Social” është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”. Vlerësimi i programit të studimit është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm i përcaktuar me urdhër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë “Për përcaktimin e Ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Kolegji Universitar “Wisdom”.

Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Kolegjin Universitar “Wisdom”, MASR, publikun e gjerë dhe studentët se si programi i studimit përmbush standardet. Përmes këtij raporti njësia kryesore dhe bazë kanë mundësi të identifikojnë prioritetet në drejtim të rritjes dhe zhvillimit, duke e vënë theksin tek përmirësimi i cilësisë në drejtim të një procesi që zhvillon kompetencat profesionale për studentët.


Standardet Shtetërore të Cilësisë janë të grupuara në pesë fusha kryesore vlerësimi, bazuar tek: Ofrimi, Organizimi dhe Drejtimi i Programit të Studimit me Karakter Profesional; Struktura dhe Përmbajtja e Programit të Studimit me Karakter Profesional; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet për Realizimin e Programit të Studimit dhe Mbështetja e Studentëve; Studentët dhe Mbështetja e tyre. Vlerësimi i secilës fushë bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve me 4 nivele: nuk përmbushen; përmbushen pjesërisht; përmbushen kryesisht; përmbushen plotësisht. Raporti në tërësinë e tij identifikon pikat e forta të programit të studimit bazuar në karakteristikat e praktikës së mirë, pikat e dobëta të cilat prekin çdo fushë, mundësitë që ka në dispozicion programi në drejtim të avancimit drejtë cilësisë dhe pengesat, të cilat mund të vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbi bazën e këtyre indikatorëve, grupi i vlerësimit të jashtëm, ka dhënë edhe rekomandimet profesionale që do të shërbejnë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të programit të studimit me karakter profesional.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga PhD. Eglantina Dervishi dhe Dr. Darina Kacollja. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Ersi Dako.

Më datë 26.08.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 51/22 Prot., datë 26.08.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, më datë 02.09.2020 përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 108 Prot., datë 01.09.2020, përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, duke shprehur dakordësinë me vlerësimet dhe konkluzionet e parashtuara. Sa më lart, Raporti merr formën e tij përfundimtare.

Shënim: Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e kushteve të jashtëzakonshme pas tërmetit të 26 Nëntorit dhe pandemisë së COVID-19. Komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë

09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, dt. 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë
19.03.2020.



Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Asistent Social”


I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Kolegji Universitar “Wisdom” (KU “Wisdom”) zotëron mekanizma të qartë në raport me funksionimin dhe organizimin e programit të studimit në përputhje me Statutin e tij të brendshëm miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 03.02.2017 të Senatit Akademik dhe Vendimin Nr. 4, datë 31.01.2017 të Bordit të Administrimit, si dhe Rregulloren e KU “Wisdom”, e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Kjo evidentohet edhe në Rregulloren e institucionit, si dhe atë të programit të studimit që mbështetet në misionin dhe qëllimet e tij dhe në linjë me nevojat e tregut të punës.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Referuar statutit ¹ por edhe rregullores së njësisë bazë ² , dhe të programit të studimit me karakter profesional “Asistent Social” ³ , ky program studimi respekton lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve, përmes një politike të brendshme që synon ndërthurjen midis kompetencave profesionale të studentit dhe pajisjen me diplomë profesionale referuar nivelit të 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për	Evidentohet se program i studimit është hartuar në frymën e kuadrit të ri ligjor dhe në përputhje me politikat e brendshme të institucionit dhe nevojave social-ekonomike të vendit. Programi i studimit me karakter profesional është në përputhje me qëllimet dhe misionin e KU “Wisdom” dhe janë të integruara në linjë me fushën e studimit brenda njësisë bazë të tij. Gjithashtu, duke iu referuar kushteve

¹ Statuti i Kolegjit Universitar “Wisdom”.

² Rregullore e njësisë kryesore/bazë.

³ Rregullore e programit të studimeve profesionale “Asistent Social”.



<p>programin e studimit.</p>	<p>specifike përsa i përket zhvillimit të profesioneve të reja, ky profil ka perspektivë të mirë të zhvillohet me tej dhe të gjej terrenin e tij të punës në kontekstin shqiptar, por edhe jashtë tij.</p>
<p>Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, i cili paracakton si kriter studimin e tregut të punës para propozimit, hartimit dhe realizimit të një programi të ri studimi, përmes dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni dhe më specifikisht vlerësimin të tregut të punës të bërë në prill 2018⁴, është realizuar një ministudim me qëllim hulumtimin e perceptimeve të të rinjve shqiptarë mbi rolin e asistentit social, <i>edhe pse referuar mënyrës se si është ndërtuar pyetëtori dhe target grupit të përzgjedhur, nuk kuptohet qartë se çfarë synonte të maste realisht studimi.</i> Gjithsesi, mbetet për tu vlerësuar nisma e njësisë bazë për të ndërmarrë një studim që lehtëson procesin e grupit të punës i cili ka hartuar këtë program studimi. Një element pozitiv lidhet me kërkimin e kryer nga grupi i punës që ka hartuar programin profesional “Asistent social” mbi eksperiencën e vendeve të zhvilluara përsa i përket organizimit të lëndëve dhe moduleve. <i>Megjithatë, për vlerësimin e tregut të punës, duhet të kihet parasysh që studimi të përfshijë një metodologji⁵ që të lejon të shfrytëzosh të gjitha gjetjet për synimet e këtij programi studimi, si dhe ky vlerësim tregu të bëhet në mënyrë periodike me qëllim që t’i jap mundësi drejtuesve të programit të përmirësojnë cilësinë e tij, në përgjigje të nevojave të tregut të punës.</i></p>
<p>Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Ky program studimi me karakter profesional është hapur së fundmi dhe si rezultat e kemi të vështirë një analizë në vijimësi të ecurisë së studentëve përsa i përket përfshirjes së tyre në tregun e punës. Studime të mëtejshme pritet të ndërmerren nga institucioni përgjatë fillimit të brezit të parë të studentëve. <i>Megjithatë, do të rezultonte me ndikim pozitiv, lobimi nga ana e institucionit mbi vizibilitetin më të madh që mund t’i bëhet figurës së asistentit social.</i> Referuar edhe kushteve në të cilat ndodhet vendi ynë ku ka një vakum përsa i përket njohjes së profesionit “Asistent Social” si një profil i veçantë në grupin e profesioneve me karakter human. Megjithatë, institucioni, duket se ka në mbështetje të punësimit të studentëve strukturën e bordit të</p>

⁴ Studimi i tregut të punës para hapjes së programit.

⁵ Minutat e vizitës në institucion faqja 5-6.

	punës si dhe panairet e punës, të cilat duhen shfrytëzuar në mënyrë më efikente me qëllim që të lehtësojë futjen shpejt në tregun e punës, të studentëve të programit profesional “Asistent Social”.			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Mbështetur në të dhënat e vëna në dispozicion, kemi angazhim të grupit të ekspertëve që kanë realizuar studimin mbi nevojat e tregut të punës për të eksploruar nevojat e tregut mbi rolin e asistentit social kjo në rang Univesiteti (nevojës për të marrë informacion mbi programe studimi të ngjashme në univesitetet e tjera brenda vendit) si dhe angazhimin e grupit të punës në kontaktimin e një sërë strukturash shtetërore që operojnë në fushën e kujdesit psiko-social në Shqipëri. Duke qenë se ky program sapo është hapur, duhet parë se si vetë KU “Wisdom” do të arrijë të konsolidojë dhe integrojë këtë program në gamën e gjerë të profesioneve që mund të ushtrohen nga studentë të kualifikuar. Promovimi dhe lobimi për të, në struktura shtetërore dhe komunitet, konsiderohen të domosdoshme për lexueshmërinë e diplomës në tregun e punës. <i>Në këtë drejtim nuk u evidentuan politika të qarta promovuese të ndërmarra nga institucioni.</i> ⁶			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes	Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë, konform rregullave të paracaktuara nga ligjet në fuqi ⁷ dhe kjo evidentohet në statutin e KU “Wisdom” ⁸ , rregulloren e KU “Wisdom” ⁹ , rregulloren e këtij programi studimi me karakter profesional ¹⁰ . Koordinimi i punës

⁶ Minutat e vizitës në institucion faqja 3-4.

⁷ Ligj Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

⁸ Statuti i “KU Wisdom”.

⁹ Rregullore e KU “Wisdom”.

¹⁰ Rregullore e programit të studimeve profesionale “Asistent Social”.

<p>njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>midis njësisë kryesore, asaj bazë dhe rolit të koordinatores së programit të studimit “Asistent Social” krijojnë një infrastrukturë të përshtatshme për mbarëvajtjen e punës në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Duke qenë se dhe vetë specifikat e ndërtimit të këtij programi studimi synojnë orientimin e studentëve drejt tregut të punës në një kohë të shkurtër dhe sipas një roli të mire përcaktuar, roli i institucioneve bashkëpunuese është i rëndësishëm. Profili i asistentit social është i nevojshëm në një sërë strukturash shtetërore apo private që ofrojnë shërbime ndaj kategorive vulnerabël. Në kuadër të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve të këtij programi studimi me karakter profesional, janë nënshkruar nga institucioni një sërë marrëveshje bashkëpunimi¹¹ (78 marrëveshje bashkëpunimi me institucione private dhe publike, brenda vendit, nga të cilat 12 janë vetëm për mbështetjen profesionale të studentëve) <i>por në to nuk shprehet qartë mënyra se si do të lehtësohet procesi i zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve, apo se si nga këto marrëveshje do të kenë mundësi të përfitojnë studentët e këtij programi studimi në drejtim të njohjes së rolit të asistentit social¹² brenda institucioneve dhe në drejtim të punësimit të tyre, duke qenë se në ogranikogramat e tyre nuk përfshihet profesioni i “Asistentit Social”.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për këtë program studimi është në fazën fillestare dhe pritet të ketë një analizë të punës së saj në drejtim të përmirësimit të cilësisë së këtij programi studimi në vijimësi pas daljes së brezit të parë. Kjo mund t’i jap mundësi njësisë bazë të analizojë edhe punën e saj nga këto marrëveshje bashkëpunimi në drejtim të praktikës profesionale. <i>Në vijim, duke iu referuar institucioneve me të cilat kanë bashkëpunuar në drejtim të praktikës profesionale, gjykojmë se ka një hapësirë për të njohur rolin e tyre të punës në mënyrë të pjesshme, pasi duke mos pasur një specialist në fushë që është kualifikuar si asistent social, do të jetë e vështirë të kuptojnë rolin e tyre dhe të mos rrezikojnë të futen as në rolin e psikologut dhe as në atë të punonjësit social.</i></p>

¹¹ Tabela Përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale.

¹² Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.

<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit janë pjesë e dokumentacionit të depozituar në kuadër të këtij procesi vlerësimi, të listuara në një tabelë përmbledhëse. <i>Sugjerohet që institucioni të mund të zgjerojë më tej bashkëpunimin e tij me institucione dhe punëmarrës potencial në drejtim të këtij programi studimi. Gjithashtu lobimi tek punëmarrësit për promovimin e kësaj figure të re në grupin e profesioneve të fushës sociale, me qëllim që të lehtësojë njohjen e rolit të tyre në komunitet dhe kontekstin profesional, është domosdoshmëri.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Në drejtim të iniciativave për punësimin e studentëve të këtij programi profesional, nuk kemi evidenca për përfshirjen e tyre në marrëdhënie pune. Por, duhet marrë në konsideratë fakti se brezi i parë i studentëve të programit “Asistent Social” diplomohet këtë vit akademik e është herët për të vlerësuar këtë aspekt. Gjithsesi, disa veprimtari si takimet me bordin e punës dhe panairët e punës, të ndërmarra nga institucioni në mënyrë periodike, duhen parë si një mundësi e mirë për të lehtësuar procesin e ndërmjetësimit të studentit me punëmarrës të ndryshëm.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi I.3

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ky program studimi i organizuar në 120 kredite (ECTS) me kohëzgjatje 2 vite akademike, i ndarë në katër semestra, është organizuar konform Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Organizimi i lëndëve/moduleve janë të vlerësuara në kredite dhe respektohet ndarja e veprimtarive formuese sipas kategorive të mëposhtme në: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Asistent</p>

<p>karakter profesional synojnë përfitim e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Social”, me 120 kredite formimi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, krijon një profil profesional të nevojshëm për nevojat e tregut të punës në kontekstin shqiptar. Kjo referuar kompetencave të përfituara përmes këtij programi, por edhe bazuar në profilin e punës, i cili duhet të themi se nuk është mbuluar nga individë të kualifikuar më parë. Kjo shihet si mundësi e mirë për të gjetur veten lehtësisht në tregun e punës por edhe për të ofruar një shërbim më cilësor për të gjithë marrësit e këtij shërbimi. Programi i studimit “Asistent Social”, referuar planit mësimor¹³, të jep njohuri të gjera në drejtim të fushës profesionale, duke zhvilluar kompetenca dhe njohuri të zgjeruara për të punuar me kategori të ndryshme të individëve me nevoja të veçanta, në kontekste të ndryshme profesionale. Kohëzgjatja e tyre normale është dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht “Diplomë profesionale”^{14, 15}.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Programi i studimit është ndërtuar me lëndë e module¹⁶ që ndihmojnë studentët të marrin njohuri të zgjeruara në drejtimin psikologjik, të punës sociale e kujdesit shëndetësor. Kjo ndërthurje midis këtyre profileve¹⁷ ndihmon zhvillimin e disa kompetencave profesionale që lehtësojnë ndërhyrjen praktike në kontekstin e punës së të diplomuarit. Mënyrë e organizimit të programit të studimit¹⁸ i mundëson studentit një njohje më të thelluar dhe ndërdisiplinore të dijeve dhe njohurive teorike mbi proceset e rëndësishme të zhvillimit dhe funksionimit të individit në raport me grupin apo komunitetin ku jeton. Një element i rëndësishëm që plotëson më së miri dhe karakterin profesional të këtij programi është edhe ndërthurja e veprimtarisë praktike¹⁹ përgjatë dy viteve të studimit si pjesë e planit mësimor. <i>Kujdesi në këtë aspekt duhet të lidhet me përshtatjen e institucioneve ku realizohet praktika profesionale me nevojat e studentëve për të përfituar përvojë të drejtpërdrejtë nga praktika në terren.</i> Institucionet, në strukturat e tyre, duhet minimalisht të kenë një punonjës që ushtron detyrat e asistentit social,</p>

¹³ Plani mësimor.

¹⁴ Model i diplomës profesionale Asistent Social.

¹⁵ Suplementi i diplomës.

¹⁶ Udhëzues didaktik i programit të studimit.

¹⁷ Plani mësimor.

¹⁸ Veprimtaria formuese e programit.

¹⁹ Udhëzuesi i praktikave.

	<p>pavarësisht emërtimit që mbart ky punonjës në strukturën e punës së institucionit. Do ishte e papërshtatshme futja e studentëve vetëm nëpër shkolla e qendra fëmijësh, kur fokusi kryesor i punës së tyre janë moshat e treta dhe të gjithë ata individë me nevoja të veçanta që kanë nevojë për një profesionist që të ndihmojë në drejtim të përkujdesjes në përditshmërinë e tyre. Rreziku është që figurat e tjera me të cilat mund të atashohen studentët gjatë praktikës, siç mund të jetë psikologu, punonjësi social, mund të krijojnë konfuzion tek ta. Por, duke iu referuar mungesës së përvojës në vendin tonë për këtë profesion të ri, mund të justifikohet vështirësia e tyre në drejtim të realizimit të praktikës profesionale. <i>Gjithsesi, sugjerohet që institucioni duhet të marrë në konsideratë aderimin e studentëve pranë qendrave të përkujdesjes rezidenciale për moshën e tretë, institucione private e publike që ofrojnë shërbime për individë me nevoja të veçanta në drejtim të përkujdesjes fizike.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Ky program studimi profesional nxit tek studenti sensin e komunitetit dhe solidaritetin për të ndihmuar të tjerët në vështirësi. Nevoja për të qenë të trajnuar në mënyrë të përshtatshme në lidhje me asistimin e personave që u përkasin kategorive vulnerabël të cilët e kanë të pamundur të kryejnë vetëm aktivitetet e jetës së përditshme, është një kusht i domosdoshëm për këtë program studimi profesional. Studentët e këtij programi studimi janë pajisur me kompetencat dhe kanë kualifikimin e duhur për të asistuar këta persona përgjatë jetës, duke ofruar mbështetje psikoemocionale dhe lehtësim në drejtim të veprimtarive konkrete për kujdesin për veten, higjienën personale, ndërmjetësimin për të marrë shërbimet e nevojshme sociale dhe komunitare sipas nevojave të personave për të cilët kujdesen. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë edhe njohuritë e tyre në drejtim të problemeve të shëndetit mendor, roli i tyre do të jetë ndihmës në drejtim të referimit dhe adresimin tek profesionisti në kohë, sa herë përballet me simptoma klinike domethënëse të problemeve të shëndetit mendor, të cilat mund të jenë në rritje tek moshja e tretë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush</p>	<p>Kolegji Universitar “Wisdom” dhe Departamenti i Psikologjisë duket se përmbush parametrat e kërkuara në drejtim të mënyrës se si ka krijuar strukturën e nevojshme në funksion të realizimit të një procesi mësimor që i</p>

<p>kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>mundëson studentëve njohuri të thelluara teoriko-praktike, mbi shërbimet e kujdesin social. Stafi i angazhuar në këtë proces ka kualifikimin e duhur profesional për të realizuar një proces të nxëni që ndihmon zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.</p> <p>Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, përbëhet nga tre njësi bazë: Departamenti i Psikologjisë (përgjegjës për këtë program studimi), Departamenti i Ekonomisë dhe Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Secila prej njësive bazë, për vitet akademike 18-19 dhe 19-20, kanë në përbërje të paktën 7 pedagogë efektivë (PAE), ku të paktën 3 janë më tituj/grada²⁰.</p> <p>Departamenti i Psikologjisë, për vitin akademik 18-19²¹, përbëhet nga 7 PAE, me kualifikimin: 1 Prof. As., 4 Dr., dhe 2 Msc., dhe 4 PAK, me kualifikimin: 2 Prof. As., dhe 2 Msc. Për vitin akademik 19-20²², Departamenti i Psikologjisë, përbëhet nga 7 PAE, me kualifikimin: 1 Prof. As., 4 Dr., dhe 2 Msc., dhe 3 PAK, me kualifikimin: 1 Prof.As., dhe 2 Dr.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi fokusohet në krijimin e profesionistëve të kualifikuar për të ofruar mbështetje në fushën e shërbimeve sociale dhe asistimit të grupeve vulnerabël. Shprehitë e reja profesionale do të ndihmojnë studentët e këtij programi studimi për të shfaqur kompetenca profesionale në drejtim të asistencës për individët apo grupet me nevoja të veçanta. Fokusimi i programit tek krijimi i shprehive bazë të komunikimit, marrja e informacionit të zgjeruar në drejtim të zhvillimit të individit, zhvillimit të aftësive në drejtim të identifikimit të nevojave dhe zgjidhjes së problemeve, të mësuarit se si të japin ndihmën e parë në një urgjencë mjekësore të klientëve të tyre, janë të gjitha njohuri të nevojshme që i pajisin studentët me kompetencat e duhura për të ushtruar profesionin e mbështetësit social.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

²⁰ Të dhëna tabelore të kërkuara nga ASCAL, vitet akademike 18-19 dhe 19-20, tabelat 1.

²¹ Të dhëna tabelore të kërkuara nga ASCAL, viti akademik 18-19, tabela 1.

²² Të dhëna tabelore të kërkuara nga ASCAL, viti akademik 19-20, tabela 1.




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1

Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1 Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Dokumentacioni që shoqëron procesin e organizimit të këtij programi profesional ²³ përmban të plotë elementët e nevojshëm që lidhen me objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen ²⁴ dhe gjithashtu paraqet një gamë të gjerë fushash të mundshme të punësimit të studentëve pas përfundimit të këtij programi profesional ²⁵ . Lidhur me të dhënat reale të punësimit të studentëve mbetet për t'u parë në vijimësi duke qenë se akoma nuk ka dalë brezi i parë i të diplomuarve, edhe pse nevojat e vendit për profesionistë të kualifikuar që ofrojnë përkujdesje për personat në nevojë janë të mëdha, duke u bazuar edhe nga të dhënat mbi rritjen e numrit të moshës së tretë në vend.
Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.	Programi i studimit "Asistent Social" ²⁶ është organizuar duke respektuar vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" ²⁷ . Lëndët dhe modulet e tij janë të ndara duke respektuar përqindjen e kërkuar sipas ndarjeve në kategori. Numri i krediteve të grumbulluara sipas ndarjes në semestra dhe për çdo vit akademik gjithashtu është konform ligjit në fuqi. Gjithashtu, i është dhënë një hapësirë më e madhe në planin mësimor ²⁸ , veprimtarive praktike, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë

²³ Udhëzues didaktik i programit të studimit.

²⁴ Plani strategjik për zhvillimin e programit.

²⁵ Studimi i tregut të punës para hapjes së programit.

²⁶ Plani mësimor.

²⁷ Vendimi Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara".

²⁸ Plani mësimor.

	<p>standardeve ligjore të vendimit Nr. 41. Ndarja sipas veprimtarive formuese²⁹ paraqitet si në vijim:</p> <p>Kategoria A: 5 lëndë, me 6 kredite secila; në total 30 ECTS;</p> <p>Kategoria B: 7 lëndë, me 8 kredite secila; në total 56 ECTS;</p> <p>Kategoria C: 4 lëndë, 2 në vitin e parë me 5 ECTS secila dhe 2 në vitin e dytë me 4 ECTS secila; në total 9 ECTS;</p> <p>Kategoria D: gjuha e huaj me 5 ECTS dhe praktika profesionale me 12 ECTS; në total 17 ECTS;</p> <p>Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – Punimi i diplomës, me 8 ECTS.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit³⁰ të ofruar nga KU “Wisdom”, siç janë plani mësimor dhe profili i programit, por edhe përmbajta e programit të lëndëve për këtë program profesional studimi, janë konform rregullave në fuqi (<i>Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018. “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”</i>). Mbështetur në disa elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tij³¹, gjykojmë se programi i pasqyron ato si pjesë të tij³². Kemi një balancë midis mënyrës së paraqitjes së informacionit mbi ngarkesën mësimore, ndarjen sipas semestrave³³, orëve në auditor dhe frekuentimin, vlerësimin e dijeve dhe një sërë akiviteteve specifike që synojnë të mbështesin aspektin praktik të përvetësimit të dijeve të akumuluar nga studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktiviteteve formuese të programit të studimit.</p>	<p>Syllabuset e programit profesional “Asistent Social” janë konform modelit të përcaktuar nga MASR në shtojcën e vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018 “<i>Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë</i>”. Syllabuset e secilës lëndë janë të organizuara sipas strukturës së mëposhtme: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, objektivat dhe konceptet themelore, temat e lëndës dhe secila prej tyre përmbajnë një sërë veprimtarish praktike që realizohen si pjesë e seminareve, duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin e koncepteve teorike nga ana e studentit. Syllabusi i praktikës gjithashtu është organizuar në mënyrë që t’u jap</p>

²⁹ Veprimtaria formuese e programit.

³⁰ Plani mësimor.

³¹ Syllabuse cover.

³² Veprimtaria formuese e programit.

³³ Kalendari akademik.

	<p>mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës. Megjithatë, mënyra se si do të implementohet në kontekstin e mësimdhënies, do të varet nga vizioni dhe të kuptuarit e informacionit nga perspektiva e një asistenti social.</p>
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Ky program studimi ka një koherencë në lidhje me elementët që synon të zhvillojë tek studenti në mënyrë që të lehtësojë realizimin e detyrave të kërkuara në tregun e punës për profesionin e “Asistentit Social”. Synimi i programit “Asistent Social” është të japë njohuri në lidhje me një sërë aspektesh të rëndësishme për zhvillimin e individit, problematikave që lidhen me shëndetin mendor dhe fizik, rëndësinë e kujdesit fizik dhe mbështetjes psiko-emocionale për kategori të ndryshme individësh që janë në kushtet e pamjaftueshmërisë për të funksionuar në mënyrë të pavarur. Gjithashtu programi përfshin elementë mbi zhvillimin e disa shprehive profesionale që e ndihmojnë asistentin social të realizojë detyrën e tij të përkujdesit për këto target grupe individësh në mënyrë profesionale.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Aspekti praktik duket se preket përgjatë lëndëve të ndryshme teorike që studentët zhvillojnë në auditor dhe angazhimit në detyrat e kursit. Gjithashtu, duket se në këtë aspekt një ndihmesë japin edhe aktivizimi pranë njësisë kryesore të një sërë klubesh studentore të cilët janë të angazhuar në nisma sociale, por edhe të ndërhyrjeve profesionale, përmendim në këtë drejtim Fondacionin “Klinika psikologjike Urtësia”³⁴. Elementi më i rëndësishëm në mbështetje të këtij kriteri lidhet me hapësirën dhe shtrirjen e praktikës profesionale përgjatë të dyja viteve të studimit. Mbështetur në sa më sipër mund të konkludojmë se programi i studimit ka në dispozicion një strukturë që favorizon përvetësimin e njohurive praktike në drejtim të rritjes së kompetencave profesionale të studentëve që ndjekin këtë program studimi profesional. Mbetet për t’u parë nëse edhe implementimi i këtij programi u krijon kushtet e përshtatshme që studentët të prekin terrenin e punës në formën e duhur nën monitorimin e një profesionisti i cili kryen rolin e asistentit social. <i>Veprimtaritë praktike të përfshira si pjesë e leksioneve specifike duhet të fokusohen tek mënyra se si zhvillohen shprehitë dhe kompetencat profesionale të lidhura me</i></p>

³⁴ Fondacioni “Klinika Psikologjike “Urtësia”.

	<i>ndërhyrjen e sukseshme, referuar profilit të asistentit social dhe jo atë të lidhur me rolin e psikologut apo punonjësit social. Ky sugjerim bazohet në shqetësimin e grupit të vlerësimit të jashtëm lidhur me mungesën e përvojës mbi këtë profesion të ri në vendin tonë, i cili duke mos pasur një traditë të gjatë në tregun e punës, mund të krijojë edhe paqartësi të rolit si nga ana e stafit akademik, ashtu edhe nga studentëve të regjistruar në këtë program.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit ³⁵ reflekton një koherencë me parashikimet e akteve ligjore referuar numrit të krediteve, 120 kredite, kohëzgjatjes normale të tij në 2 vite akademike, tipologjisë së lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, vlerësimin në kredite e orë mësimore, si dhe shpërndarjes së ngarkesës mësimore në vite akademike dhe semestra. Planin mësimor ³⁶ është konform legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, me Statutin ³⁷ dhe Rregulloren e KU “Wisdom” ³⁸ .
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave	Lëndët kanë një shpërndarje në semestra ³⁹ që respekton kuadrin ligjor ⁴⁰ përsa i përket vlerësimit në kredite dhe orë mësimore, si dhe u jep mundësinë studentëve të zhvillojnë të gjitha njohuritë që synojnë të përvetësojnë në këtë

³⁵ Veprimtaria formuese e programit.

³⁶ Planin mësimor.

³⁷ Statuti i KU Wisdom.

³⁸ Rregullore e KU Wisdom.

³⁹ Veprimtaria formuese e programit.

⁴⁰ VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

<p>formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>rrugëtim profesional. <i>Sugjerojmë të tregohet kujdes në drejtim të promovimit dhe lobimit në instancat e duhura në mënyrë që ky kualifikim profesional të njihet si profesion i rregulluar dhe të bëhet pjesë në organikën e një sërë institucionesh shtetërore apo private që ofrojnë shërbime të kujdesit dhe asistencës për individët me nevoja të veçanta, veçanërisht për moshën e tretë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Struktura e programit⁴¹, lëndët dhe emërtimi i tyre referuar programit profesional “Asistent social”, përfshin kryesisht lëndë të rezervuara metodologjisë dhe teorisë të psikologjisë, si dhe një pikëprerje me lëndë të sociologjisë, mjekësisë dhe punës sociale. Kjo konsiderohet e rëndësishme për disiplinën e profilit të asistentit social, pasi profili profesional i tij, përgjatë rrugës së zhvillimit, është mbështetur në këto disiplina për t’u zhvilluar. Arsyja pse kurrikula e këtij programi profesional përfshin lëndë të tjera bazë nga profile të përafërta, bëhet me qëllim që të balancohen njohuritë e mjaftueshme të studentit në lidhje me zhvillimin e dijeve, kompetencave në drejtim të studimit të individëve, grupeve dhe shoqërisë. Përsa i përket raportit teori/praktikë⁴², për lëndët përkatëse, vlerësohet të jetë konform ligjeve në fuqi.</p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Nëse i referohemi planit mësimor⁴³ kemi një ndarje të balancuar midis veprimtarive formuese të cilat zhvillohen në auditor dhe jashtë tij. Këto veprimtari kanë të ndërthurura aspektet teorike dhe praktike që të lejojnë aftësimin e studentit në përvetësimin e shprehive të nevojshme për të realizuar punën konkrete gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Praktika profesionale⁴⁴ gjithashtu mbështet plotësisht nevojat e programit profesional për zhvillim kompetencash dhe aftësisish të nevojshme për të gjetur veten lehtësisht në tregun e punës. <i>Sugjerimet tona lidhen me nevojën për të përzgjedhur në mënyrë më të kujdesshme institucionet e praktikës, me qëllim që tu shërbejnë nevojave të studentëve të këtij profili për t’u përballur me marrësit e vërtetë dhe potencial të shërbimit të tyre.</i></p>

⁴¹ Plani mësimor.

⁴² Plani mësimor.

⁴³ Plani mësimor.

⁴⁴ Udhëzuesi i praktikave.

<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nëse i referohemi veprimtarive formuese⁴⁵ dhe raportit midis formimit teorik dhe praktik⁴⁶, parimisht të lejon mundësinë për transferim kreditesh, mobilitetit⁴⁷, pasi janë konform udhëzimeve të MARS. Edhe pse ky program shihet si një indikator pozitiv përse i përket pritshmërive të institucionit për vizibilitet më të madh në tregun e punës, mbetet për t'u parë nëse ky proces do të ketë ecuri normale dhe do të konsolidohet. Duke qenë se është program i hapur së fundmi, duhet parë mënyra se si do t'i përthithë tregu studentët e diplomuar ndër vite. Por gjithashtu, edhe mënyra se si vetë institucioni do të dijë të krijojë strategji efikase lobimi dhe promovimi të vetvetes dhe programit “Asistent Social”, i cili është i vetëm në llojin e tij, ofruar nga një Institucion i Arsimit të Lartë në vend.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>I idhur me procedurat që ndjek institucioni në drejtim të realizimit të programit të studimit⁴⁸, kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve⁴⁹ të lëndëve sipas ligjeve shtetërore dhe sipas formatit të miratuar nga MASR dhe i njëjti drejtim ndiqet edhe nga rregullorja mësimore e programit të studimit⁵⁰, e cila përcakton parimet e përgjithshme për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e</p>	<p>Ky program studimi⁵¹ i përgjigjet më së miri nevojave aktuale të vendit, por edhe nevojave të tregut ndërkombëtar përse i përket profesionistëve që ofrojnë shërbime të asistencës në komunitet të ndryshme. Dinamika e jetës dhe individualizmi që</p>

⁴⁵ Veprimtaria formuese e programit.

⁴⁶ Plani mësimor.

⁴⁷ Rregullore e programit të studimeve profesionale të larta “Asistent Social”.

⁴⁸ Plani mësimor.

⁴⁹ Syllabusi cover.

⁵⁰ Rregullore e programit të studimeve profesionale të larta “Asistent Social”.

⁵¹ Plani mësimor.

<p>kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>bashkëshoqëron orientimin e shoqërisë drejt punës dhe angazhimeve të tjera kërkon profesionistë të kualifikuar të cilët kanë kompetenca profesionale për t'u kujdesur për të moshuar, fëmijë me nevoja të veçanta, individë me vështirësi fizike, mendore etj. Ndërthurja e njohurive dhe shprehive profesionale⁵² që synohen të përvetësohen përmes këtij programi studimi profesional do t'i ndihmojë studentët të zotërojnë asetet e nevojshme të pritshme nga punëdhënësit e tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Studentët të cilët përfundojnë këtë program studimi⁵³ kanë mundësi që të fitojnë njohuri dhe kompetenca për të punuar në një sërë kontekstesh me persona të cilët kanë nevoja të veçanta. Modulet e këtij programi profesional⁵⁴ të japin mundësi për marrjen e njohurive bazë për të punuar me tipologji të ndryshme individësh. Prezenca e një larmishmërie metodash që aplikohen në këtë program studimi^{55, 56, 57} të japin mundësi të mira në avancimin e studentit në drejtim të përvetësimit të njohurive të nevojshme. Format e vlerësimit të njohurive janë konform rregullave⁵⁸ të brendshme institucionale dhe ligjeve në fuqi për arsimin e lartë.</p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim të njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>Mënyra se si janë ndërtuar modulet e lëndëve^{59, 60} të japin mundësi për fitimin e shprehive profesionale. Një sërë aktivitetesh të formimit teorik dhe praktik^{61, 62} të cilat janë pjesë e syllabusit të lëndëve, të japin hapësirat e nevojshme për të përthyer në mënyrë të duhur aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme që i lejojnë asistentit social të zhvillojë disa kompetenca profesionale si: zgjidhja e problemeve, aftësi të mira komunikimi dhe ndërveprimi me njerëzit, të nevojshme për një vizibilitet më të madh në tregun e punës. <i>Megjithatë, një vëmendje më e shtuar në përfshirjen e temave mësimore, të rasteve praktike lidhur me rolin e asistentit social, do të përmirësonte cilësinë në mësimnxënie dhe njohjen e këtij roli në një mënyrë më të konsoliduar nga ana e studentëve.</i></p>

⁵² Veprimtaria formuese e programit.

⁵³ Plani mësimor.

⁵⁴ Veprimtaria formuese e programit.

⁵⁵ Afësimi nëpërmjet lojës.

⁵⁶ Njohuri mbi trupin dhe funksionet.

⁵⁷ Menaxhim stresi.

⁵⁸ Rregullore e programit të studimeve profesionale të lata "Asistent Social".

⁵⁹ Hyrje në psikologji zhvillimi.

⁶⁰ Sëmundjet dhe trajtimi i tyre.

⁶¹ Logopedi.

⁶² Menaxhim rasti.

<p>Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit⁶³, KU Wisdom ka lidhur rreth 78 marrëveshje bashkëpunimi, prej të cilave 12 janë vetëm për praktikat profesionale të studentëve^{64,65,66,67}. Më tej, sipas të dhënave të vëna në dispozicion, kemi organizimin e një sërë aktivitetesh ekstrakurrikulare⁶⁸, ndër to, leksione të hapura me të ftuar të fushave të ndryshme⁶⁹. Në planin e përgjithshëm studentët e programit profesional “Asistent Social” mund të përfitojnë nga këto aktivitete, por <i>sugjerohet të ndërmerren nisma të tilla ku në qendër vendosin figurën e asistentit social, dhe jo të psikologut, psikoterapistit. Kjo me qëllim që të lehtësohet kuptimi i rolit të asistentit social, të njihen detyrat që ushtrohen prej tij në kontekstin e punës, sfidat e përditshme, dhe nevojat për trajnim të mëtejshëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Asnjë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p>Standardi III.1 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton</p>	<p>Institucioni ka në funksion të përmirësimit të cilësisë në</p>

⁶³ Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.

⁶⁴ KU Wisdom dhe Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë.

⁶⁵ Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës.

⁶⁶ Shkollia e mesme jopublike “Kristaq Rama”.

⁶⁷ Instituti i nxënësve që nuk dëgjojnë.

⁶⁸ Dokument nga trajnimi i stafit akademik për implementimin e metodave innovative në mësimdhënie.

⁶⁹ Relaçione lidhur me aktivitetin e trajnimeve profesionale nga organizata profesionale.

udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.

mësimdhënie një sërë dokumentash institucionale si Statuti⁷⁰ dhe rregulloren e institucionit^{71, 72, 73, 74}. Gjithashtu në mbështetje të programit të studimit me karakter profesional “Asistent social” është dhe rregullorja e programit të studimit⁷⁵ dhe përcaktimi i koordinorit⁷⁶ të programit të studimit në një rol monitorues në vijimësi⁷⁷. Përveç këtyre dokumentave, janë ngritur disa struktura të tjera që monitorojnë avancimin e programit të studimit konform rregullave dhe në linjë me vizionin e KU “Wisdom”, siç është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë⁷⁸ e cila është e përbërë nga 5 anëtarë të njësive kryesorë të KU “Wisdom”. Në drejtim të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie, kjo strukturë ndërmerr në mënyrë periodike aktivitete që kanë të bëjnë me administrimin e pyetësorëve për studentët⁷⁹ dhe për stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie⁸⁰. Gjithashtu ajo bën përpunimin e këtyre rezultateve dhe më pas bën shpërndarjen e informacionit në rang dekanati dhe departamenti. *Sugjerohet që informacioni të shpërndahet tek studentët, duke organizuar një takim të hapur me student dhe pedagog për të diskutuar mbi ecurinë dhe problematikat që kanë nevojë të adresohen.*

Kjo praktikë do të respektojte të drejtat e të gjitha palëve të përfshira për t’u informuar, duke mos përjashtuar asnjë individ. E drejta e studentit për t’u vënë në dijeni të rezultateve të vlerësimit nuk mund të tjetërsohet në asnjë formë.

Institucioni ka realizuar trajnime për stafin për rifreskimin e njohurive për përdorimin e sistemit LMS, gjithashtu vendimi për emërimin e koordinorit të programit të studimit⁸¹, formati për monitorimin e silabuseve⁸², dokumenti mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës⁸³,

⁷⁰ Statuti i KU Wisdom.

⁷¹ Rregullore e KU Wisdom.

⁷² Plan pune i NJSBC për vitin akademik 2019-2020.

⁷³ Plani strategjik për zhvillimin e programit.

⁷⁴ Rregullore e Njesisë së Zhvillimit të Brendshëm të Cilësisë.

⁷⁵ Rregullorja e programit të studimeve profesionale të larta “Asistent Social”.

⁷⁶ Vendimi për emërimin e koordinorit të programit të studimit, detyrat e kordinatorit.

⁷⁷ Model raporti mujor të koordinorit të programit të njësisë.

⁷⁸ Plan pune i NJSBC për vitin akademik 2019-2020.

⁷⁹ Pyetësori i studentit cover.

⁸⁰ Pyetësori i stafit akademik.

⁸¹ Vendimi për emërimin e koordinorëve të programit.

⁸² Formatit i relacionit për monitorimin e silabuseve.

⁸³ Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.

	janë dokumenta që synojnë trajnimin dhe monitorimin në përmirësimin e metodave inovative në mësimdhënie.
Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.	Nga bisedat me stafin akademik të brendshëm e të jashtëm ⁸⁴ , takimet me studentët dhe të tjerë aktorë, mësohet se sistemi i transmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet dhe seminarët, kjo e mbështetur në formën interaktive të zhvillimit të njohurive, në funksion të një të kuptuari më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione. Këtyre dy formave të mësimdhënies e mësimnxënies u shtohen detyrat e kursit, punimet në grup, provimet e ndërmjetme, dhe provimet përfundimtare ⁸⁵ . Veprimtaritë e tjera ndihmëse si leksionet e hapura ⁸⁶ me të ftuar të profileve të përafërta me këtë program studimi, konferencat shkencore ⁸⁷ , gjithashtu janë në funksion të diversifikimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm ^{88, 89, 90, 91, 92} kërkohet një angazhim më i madh i strukturave të institucionit në drejtim të pasurimit të fondit të bibliotekës dhe gjithashtu vet stafi akademik i angazhuar në këtë program profesional studimi, për të përditësuar dhe pasuruar syllabuset e lëndëve me literaturë të viteve të fundit.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e	Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga institucioni, stafi akademik ⁹³ i angazhuar në këtë program studimi kanë kualifikimin e duhur dhe kompetencat e

⁸⁴ Minutat e vizitës në institucion.

⁸⁵ Plani mëaimor.

⁸⁶ Dokument nga trajnimi i stafit akademik për implementimin e metodave inovative në mësimdhënie.

⁸⁷ Relacione lidhur me aktivitetin e trajnimeve profesionale nga organizata profesionale.

⁸⁸ RVB Asistent Social.

⁸⁹ CV E. M.

⁹⁰ CV A. P.

⁹¹ CV E.S.

⁹² CV V.B.

⁹³ Personeli akademik.

<p>njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>nevojshme për realizuar një proces të të nxënit i cili u mundëson studentëve të përfitojnë nga ndërthurja me një sërë formash interaktive në mësimdhënie. Nga vlerësimi i mënyrave se si janë hartuar syllabuset ⁹⁴, ka larmishmëri përse i përket formave të përdorura në mësimdhënie, duke e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimt. Këto forma i përshtaten shumë mirë disiplinës së “Asistentit Social” dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri mbi fushën. Gjithashtu, nga studentët për pedagogët pati në përgjithësi komente pozitive mbi formën e realizimit të leksioneve dhe seminareve⁹⁵.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në drejtim të politikave të ndërmarra nga institucioni mbi mbështetjen e stafit për të avancuar në drejtim të zhvillimit të dijeve dhe kompetencave për fushën e tij të ekspertizës, kemi disa aktivitete të dokumentuara nga KU “Wisdom”. Ndër to përmendet aktiviteti i trajnimit 2 ditor⁹⁶ nga një profesor i ftuar. Një element tjetër është edhe mobiliteti i stafit akademik përmes Erasmus Plus⁹⁷ në projekte ndërkombëtare. Realizimi i një sërë aktiviteteve ekstrakurrikulare nga departamenti i psikologjisë me lektorë të ftuar, të huaj dhe vendas është një tjetër element pozitiv në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe shkëmbimit të eksperiencave në format inovative të mësimnxënies.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore,</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion infrastrukturën fizike të nevojshme për realizimin e procesit mësimor në dy godina</p>

⁹⁴ Syllabuse cover.

⁹⁵ Minutat e vizitës në institucion.

⁹⁶ Dokument nga trajnimi i stafit akademik për implementimin e metodave inovative të mësimdhënies.

⁹⁷ Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.




<p>funkionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>me sipërfaqje prej 1260 m², godina e parë me sipërfaqje 1.262 m² dhe godina e dytë me sipërfaqje 418 m²⁹⁸. Për përdorim të procesit mësimor janë dy salla, përkatësisht sallat 11, 12⁹⁹. Sallat janë të pastra dhe mirëmbahen nga stafi i kontraktuar për këtë shërbim. Gjithashtu institucioni disponon dhe një laborator informatike me kapacitet rreth 22 vende i pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një mjedis cilësor të mësimnxënies.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Ambjentet në mbështetje të procesit mësimor janë brenda standardeve dhe janë funksionale, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si videoprojektor, kompjutera. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor një laborator informatike me 22 vende, bibliotekën online në ProQuest dhe Cobis.net¹⁰⁰. Gjithashtu një ambient që është në shërbim të stafit dhe studentëve në lidhje me avancimin e tyre në drejtim të hulumtimit të literaturës për aspekte të ndryshme që lidhen me procesin mësimor është dhe biblioteka, e cila ka një kapacitet prej rreth 15 vendesh, me infrastrukturën e nevojshme si laptop dhe internet. Në mbështetje të nevojave të studentëve dhe stafit akademik janë në dispozicion platforma digjitale, që lejon stafin dhe studentët të komunikojnë në kohë reale dhe të informohen në lidhje me vlersimet e marra në provime, detyra kursi etj. Platforma ka qenë mjet efikas në kushtet e pandemisë, duke lejuar stafin, studentet dhe personelin administrativ në mbështetje të procesit mësimor të kryejnë një sër detyrash on-line.</p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të vënë në dispozicion, KU “Wisdom” ofron rreth 80.705 tituj në total¹⁰¹, tekste elektronike për programin profesional “Asistent Social”; kjo mund të konsiderohet një arritje në drejtim të këtij programi studimi, por, gjatë vizitës në institucion, patëm mundësi të qartësohemi në lidhje me këtë aspekt në takimin me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm¹⁰². Titujt elektronik i referohen në total numrit të publikimeve elektronike që janë në dispozicion për të gjitha fushat e studimit. Kjo nënkupton tekste mësimore që i shërbejnë këtij programi profesional dhe mund të ndihmojnë stafin dhe studentët për të arritur objektivat e tyre mësimore dhe formative në</p>

⁹⁸ Kontratë huadhënieje KU-Wisdom.

⁹⁹ Përdorimi i sallave për programin e studimit me karakter profesional Asistent Social.

¹⁰⁰ Kontrata e blerjes së Pro-Quest dhe e katalogut online Cobis.

¹⁰¹ Relacioni i bibliotekës për departamentin e psikologjisë, faqja 3.

¹⁰² Minutat e vizitës në institucionin KU Wisdom.

	<p>drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale të këtij profesionisti të ri i cili akoma nuk njihet si profesion zyrtarisht nga shteti shqiptar. Megjithatë, pedagogët dhe studentët shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike. <i>Duke qenë se ky program është i karakterit profesional, është e rëndësishme të merret në konsideratë fakti që target grupi i synuar për tu regjistruar në të, nuk e kanë pikë të fortë gjuhën e huaj dhe në këto kushte mbetet e vështirë të shfrytëzohen këto tituj në gjuhën e huaj nga studentët e këtij programi studimi.</i> Në fondin e bibliotekës janë rreth 1271 tituj fizik dhe 3326 libra fizik, dhe rreth 150 tituj fizik janë për psikologjinë. Nga ana tjetër nëse i referohemi dokumentacionit mbi pasurimin e departamentit me bazën materiale didaktike në funksion të procesit mësimor që mban datën 11.10.2019¹⁰³, janë planifikuar blerje e teksteve bazë të miratuara për studentët me vit botimi të pas 2010. Ndërsa një dokument tjetër që mban datën 13.11.2019¹⁰⁴ mbi tekstet e propozuara nga departamenti për vitin akademik 2019-2020, përmban një listë me tekste, <i>ku një pjesë e tyre janë me botime më të hershme dhe sipas mendimit të GVJ paraqesin probleme serioze në mënyrën e përkthimit në gjuhën shqipe, ku terminologjia e fushës së psikologjisë është tjetërsuar duke e bërë të vështirë të kuptuarit e tekstit. Sugjerimi në lidhje me tekstet lidhet me vlerësim drejtë të atyre teksteve që realisht u shërbejnë studentëve të këtij programi studimi dhe që plotësojnë disa parametra në drejtim të cilësisë dhe standardeve të kërkimit shkencor, në mënyrë që të përdoren si tekste bazë në mësimdhënie, e që lidhen me fushën e ngushtë të studimit "Asistent Social".</i></p>
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformën elektronike të aksesimit në bibliotekën online të ProQuest dhe sistemit COBISS Net (<i>sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online</i>), ku janë të përfshira vendet e rajonit të Europës Juglindore. Gjithashtu, mund të thuhet se fondi i bibliotekës së institucionit kishte tekste në formë elektronike të fushës sociale në gjuhë të huaj që viheshin në dispozicion të stafit dhe studentëve të programit të studimit. <i>Abonimi në revista profesionale specifike</i></p>

¹⁰³ Vendimi i departamentit për materialet didaktike.

¹⁰⁴ Propozim nga departamenti i psikologjisë për zgjerimin e titujve në bibliotekë.

	<p><i>ndoshta do të ndihmonte stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie në këtë program profesional, të vihen në dijeni me avancimet më të fundit në këtë fushë dhe problemet me të cilat përballen profesionistët sot në botë, por edhe për të qartësuar konceptin mbi rolin e asistentit social.</i></p> <p><i>Shqetësim mbetet fakti se si mund ta shfrytëzojnë këtë mundësi studentët e këtij programi studimi, duke qenë se tekstet janë në gjuhë të huaj.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Infrastruktura në mbështetje të zhvillimit të detyrave të ndryshme nga studentët ishte e përshtatshme dhe të lejonte akses në bibliotekën e KU “Wisdom”, e cila ishte e pajisur me sallë leximi dhe hapësira komode për të punuar me literaturën, laptop në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë literaturën on-line të vëna në dispozicion përmes shfrytëzimit të platformave online Cobiss, Pro-Quest. Laboratori i informatikës mund të përdoret për detyra kursi, projekte dhe veprimtari të tjera që janë në funksion të nevojave dhe programit të lëndëve dhe moduleve specifike.</p>			
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Si infrastrukturë teknologjike në funksion të mësimdhënies është platforma on-line (e-learning) që lejon studentët dhe stafin akademik të mund të komunikojnë dhe ndërveprojnë për qëllime të procesit të të nxënit. Në këtë drejtim infrastruktura që disponohet ka të bëjë me një sallë informatike e pajisur me 24 kompjutera, biblioteka me platformën elektronike Pro-Quest dhe Cobiss Net¹⁰⁵, abonimi në bibliotekën elektronike të sipërcituar, platforma on-line apo e-learnig që lejon ndërveprimin e stafit apo studentëve. Platforma on-line presupozohet u jep mundësi studentëve të kenë akses në dokumenta dhe materiale didaktike të pedagogëve të lëndëve të ndryshme on-line, apo marrjen e shërbimeve on-line si regjistrimi për provime, marrja e vlerësimeve duke përdorur sistemin elektronik etj. Ky element disponohet nga KU “Wisdom” dhe është shfrytëzuar maksimalisht në kushtet e diktuar nga pandemia për të përshtatur mësimdhënien në nevojat e reja.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Ngj përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

¹⁰⁵ Të dhëna të plota për platformat online etj.

Standardi III.3

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie, bazuar në Statut ¹⁰⁶ , Rregulloren e KU-Wisdom ¹⁰⁷ , Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ¹⁰⁸ , Planit Strategjik i Zhvillimit të KU-Wisdom ¹⁰⁹ . Puna e këtyre strukturave synon monitormin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standardet shtetërore dhe ato ndërkombëtare.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Roli i njësisë kryesore dhe bazë në drejtim të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në mësimdhënie shfaqet si përmbushës nevojash në drejtim të përzgjedhjes e angazhimit të personelit akademik në mësimdhënie, monitorimit të punës së stafit në drejtim të realizimit të planit mësimor, metodave inovative në mësimdhënie, avancimit në drejtim të kërkimit shkencor, si dhe përthyerjen e tyre në procesin e mësimdhënies ¹¹⁰ . Stafi i angazhuar nga njësia bazë, në këtë program studimi është e përafërt me profilin e programit të studimit duke përfshirë një staf që plotëson nevojat e kërkesat e lëndës që ato mbulojnë. Njësia bazë dhe ajo kryesore ka ndërmarrë një sërë veprimtarish që synojnë të monitorojnë në vijimësi punën e personelit akademik dhe studentëve ¹¹¹ , ¹¹² , ¹¹³ në drejtim të cilësisë në këtë program studimi. Këto procedura që ndiqen nga institucioni mbi monitorimin e procesit të mësimdhënies përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti ¹¹⁴ , dhe formulari i vlerësimit të pedagogut ¹¹⁵ ,

¹⁰⁶ Statuti i KU-Wisdom.

¹⁰⁷ Rregullore e KU-Wisdom.

¹⁰⁸ Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Brendshëm të Cilësisë.

¹⁰⁹ Plani Strategjik i Zhvillimit të KU-Wisdom.

¹¹⁰ Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të rprogramit të studimit dhe rezultateve të protshme të të nxëniet dhe aftësisimit profesional.

¹¹¹ Pyetëtori i studentëve

¹¹² Pyetëtori i stafit akademik.

¹¹³ Plan pune i NJSBC për vitin akademik 2019-2020.

¹¹⁴ Pyetëtori i studentëve.

¹¹⁵ Pyetëtori i stafit akademik.

	synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	Personeli i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e duhur si dhe fusha e tyre e ekspertizës është në përputhje me lëndët apo modulet që mbulojnë në këtë program studimi profesional. Në lidhje me trajnimet, përsa i përket personelit akademik, për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja mund të përmendim trajnimin e zhvilluar nga një profesor i huaj mbi metodat inovative në mësimdhënie ¹¹⁶ . Përfshirja e një sërë aktiviteteve ¹¹⁷ si studime rastesh, teste profesionale, video, ese ndihmojnë procesin e të nxënësve dhe lehtësojnë përvetësimin e materialit teorik më lehtësisht nga studentët e këtij programi profesional. <i>Sugjerohet të tregohet kujdes në përshtatjen e pjesës praktike me nevojat e këtij profili profesional si dhe ndërthurja e veprimtarive praktike që kanë në fokus figurën e asistentit social dhe bazohen tek përvoja e tij e punës.</i>
Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.	Strukturat dhe njësitë bazë duket se inkurajojnë format e reja dhe inovative në mësimdhënie përmes hapësirave në drejtim të organizimit të leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion janë realizuar rreth 33 veprimari ekstrakurrikulare, ku janë abgazuar 6 lektorë të huaj për trajnime dhe leksione të hapura. Janë zbatuar 6 projekte në shkallë fakulteti, ku njëri prej tyre ishte ai i Erasmus Plus. Institucioni duket se bën përpjekje në këtë drejtim përmes kërkesës për përditësim të literaturës për lëndët përkatëse dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor përmes krijimit të mundësisë për pjesëmarrje në konferenca dhe trajnime profesionale të stafit akademik, mobilitetit të stafit përmes programit Erasmus Plus, shfrytëzimit të bibliotekës online, etj.
Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në	Në lidhje me këtë kriter nuk kemi evidencë të qarta përsa i përket testimit dhe analizës nga ana e stafit mbi metodat e reja në mësimdhënie. Duke iu referuar të dhënave të raportit të vlerësimit të brendshëm kemi përdorimin e videoprojektorit, power-pointit, studimeve të rastit, role - paly ¹¹⁸ . Edhe gjatë vizitës ¹¹⁹ në institucion komunikimi me

¹¹⁶ Dokument mbi trajnimin e stafit akademik për implementimin e metodave inovative në mësimdhënie.

¹¹⁷ Vendimi i departamentit për materialet didaktike.

¹¹⁸ RVB Asistent Social.

¹¹⁹ Minutat e vizitës në institucionin KU Wisdom.

strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	stafin e pranishëm në takim nuk na dha mundësi të qartësohemi plotësisht në lidhje me këtë aspekt.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit ¹²⁰ , sistemin e vlerësimit të studentit, formatin e tezës së provimit përfundimtar. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët përmes sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogut të lëndës në fillim të çdo semestri. Kjo procedurë respektohet nga stafi akademik dhe studentët informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve, në orët e para, si dhe ky informacion i jepet studentit në departamentin e psikologjisë.
Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Studentit i jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes vlerësimit nga detyrat e kursit, mendimet dhe reflektimet personale të shpalosura në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm dhe final me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit. Në këtë mënyrë studentit i jepet mundësia të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në varësi të stilit personal të të nxënit ku përfshihen testimet e ndërmjetme dhe ato finale, detyrat e kursit individuale etj.
Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe	Bazuar në hartimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit me karakter profesional, në fillim të çdo semestri, nga titullari i lëndës bëhet njohja me të gjitha aspektet që përfshijnë studentët ¹²¹ . Kjo procedurë ndiqej nga stafi

¹²⁰ Rregullore e programit të studimeve profesionale të larta "Asistent Social".

¹²¹ Modeli i një syllabusi.

aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	akademik ¹²² dhe u lejonte studentëve të kishin informacion të plotë mbi metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe zhvillimit të kompetencave profesionale duke respektuar syllabuset e lëndëve apo moduleve të ndryshme të hartuara nga titullari dhe të miratuara nga përgjegjësi i njësisë bazë.
Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar ¹²³ për programin e studimit. <i>Nuk kemi evidencë për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik.</i>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Njësia bazë ka një strukturë të mirëorganizuar në drejtim të hapave e procedurave që ndjek në drejtim të miratimit dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit nga pedagogu i lëndës. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, por ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik ¹²⁴ , bazuar në vendimin e komisionit të provimeve sezonale. Praktikant profesional, provimi i përgjithshëm përfundimtar, realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e sekretarisë mësimore, që bën sekretimin e tezave. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimat e çdo studenti. Ç' sekretimi i tezave të korrigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën ç' sekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. Ndjekja e kësaj procedura krijon kushtet e nevojshme për një proces korrekt dhe që respekton të standardet e cilësisë përsa i përket nevojave të studentëve për të mësuar nga gabimet dhe për t'u përmirësuar në vazhdimësi.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale	Institucioni disponon një strukturë të mirëfilitpërsa i përket gjithë procesit që lidhet me procedurat e provimit,

¹²² Minutat e vizitës në institucionin KU Wisdom.

¹²³ Programi përfundimtar i provimit të programit profesional të studimeve të larta "Asistent Social".

¹²⁴ Vendimi për ngritjen e komisioneve të provimeve sezonale.

<p>bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimimit nga ana e studentit. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse se si bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, ku studentit i llogaritet nota në bazë të një vlerësimi të ndarë në vlersim nga provimi i ndërmjetëm, detyrë kursi, provimi final. Për hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi kërkohej që studenti të ketë frekuentuar në masën mbi 75 %. Institucioni respekton procedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Kontrolli i dijës së studentit është i shtrirë në kohë dhe realizohet nga pedagogu i lëndës. Si rregull në vlersimin e dijeve të studentit, pedagogu mbështetet në kontrollin e vazhdueshëm si frekuentimi, pjesëmarrje në leksione e seminare, detyra kursi e punë të tjera krijuese, kolektime dhe provimin përfundimtar. Provimi është forma kryesore e vlersimit të nivelit të përvetësimit të njohurive gjatë kursit teoriko-praktik të një lënde. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit¹²⁵.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim të njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet</p>	<p>Programi i studimit¹²⁶ me karakter profesionali u jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë profilesh në kontekstin e psikologjisë¹²⁷, sociologjisë¹²⁸ dhe punës sociale¹²⁹, dhe pjesërisht të mjekësisë¹³⁰ me fokus në dhënie të ndihmës së shpejtë dhe të ndërhyrjes në një emergjencë mjekësore. Duket se kjo larmishmëri mund të shihet si pozitive në drejtim të thellimit të njohurive për</p>

¹²⁵ Rregullore e programit të studimeve profesionale të larta "Asistent social".

¹²⁶ Plani mësimor.

¹²⁷ Hyrje në psikologji zhvillimi.

¹²⁸ Komunikimi dhe marrëdhëniet shoqërore.

¹²⁹ Menaxhim rasti.

¹³⁰ Njohuri mbi trupin dhe funksionimin e tij.

me karakter profesional.	aspektet më të imta që lidhen me fushën dhe në një aftësi për të zhvilluar kompetenca profesionale te studenti përsa i përket profilit të “Asistentit social”.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.	Njësia bazë dhe ky program studimi krijojnë të gjitha kushtet që studenti të zhvillojë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit si në aspektin teorik përmes lëndëve që janë pjesë e kurrikulës për këtë program studimi, por edhe praktikisht përmes hapësirave që u jepen studentëve për të përdorur sistemin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online. Në drejtim të komunikimit dhe ndërveprimit kemi një sërë modulesh që ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve ¹³¹ , si psh, grupet e praktikës profesionale ku janë përfshirë studentët. Veprimtari ekstrakurrikulare si konferenca dhe leksione të hapura, që u japin mundësi ndërveprimit duke mbështetur diskutimet në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve apo çështjeve të caktuara, janë aktivitete që ndihmojnë në përvetësimin e njohurive të reja mbi fushën.
Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia ¹³² bazohet në diskutimet e ndryshme, nxitjen e mendimit kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentin në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxënit në tërësi. Ky program me karakter profesional i jep një rëndësi të veçantë përvojës së praktikës profesionale ¹³³ , si një aset i domosdoshëm për zhvillimin e kompetencave të studentëve. Por, edhe disa module të lëndëve karakterizuese, jo vetëm kërkojnë njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu edhe njohuri dhe kompetenca praktike që duhen zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë. Në drejtim të mobilitetit të studentëve të këtij programi studimi evidencat tregojnë përfshirjen e studentëve në institucione të ndryshme për praktikë, por mbetet për t’u parë efikasiteti i saj në raport me figurat profesionale që monitorojnë studentët në terren. Kjo pasi roli i asistentit social nuk mund të zëvendësohet nga psikologu, punonjësi social apo mësuesi.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli	Programi i studimit “Asistentit Social” përfshin si pjesë të procedurave për stafin akademik një raport semestral ¹³⁴ me

¹³¹ Udhëzuesi didaktik i programit të studimit.

¹³² Syllabuse cover.

¹³³ Udhëzuesi i praktikave.

¹³⁴ Model raporti semestral.

<p>akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>qëllim analizën e vlerësimin e kompetencave dhe aftësive të fituara nga studentët për çdo modul apo lëndë. Raporti i vlerësimit të pedagogut në përfundim të lëndës mbi ecurinë e saj dhe arrijten e objektivave formative në raport me mësimnxënien është pjesë e procedurave që ndiqen nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Institucioni ka hartuar procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve, të mbështetura në rregulloren e programit të studimit¹³⁵ me karakter profesional dhe mbi udhëzuesin¹³⁶ e provimit të përgjithshëm përfundimtar, të hartuara nga njësia bazë për përgatitjen e studentëve, të cilët do të japin provimin final. Mbështetur në procedurat e njësisë bazë mbi administrimin e provimit final, komisioni i ngritur për këtë qëllim ndjek parimin e respektimit të kriterit ku për secilën kategori mund të ofrohen një numër i ndryshëm pyetjesh, për lëndë të kategorisë A, lëndë të kategorisë B. Përgjithësisht respektohet balanca në testimin e njohurive të dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të instancave përkatëse, apo nevojave të vet institucionit. Në këtë program studimi, ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës,</p>	<p>Sikurse përmendur edhe më lart, ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve në këtë program të ri studimi. Duke qenë një program studimi¹³⁷ me karakter profesional, diplomimi i studentëve realizohet përmes provimit të përgjithshëm përfundimtar¹³⁸, i cili hartohet nga komisioni i</p>

¹³⁵ Rregullore e programit të studimeve profesionale të larta "Asistent social".

¹³⁶ Programi përfundimtar i provimit të programit profesional të studimeve të larta "Asistent Social".

¹³⁷ Plani mësimor.

¹³⁸ Rregullore e programit të studimeve profesionale të larta Asistent social.

realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	provimit. Studentët pajisen me një udhëzues për provimin e përgjithshëm përfundimtar ¹³⁹ nga departamenti me qëllim përgatitjen e tyre për t'u përballur me sukses me këtë proces. Staf i akademik i këtij programi studimi ka rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për provimin e përgjithshëm përfundimtar duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët nëse kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me lëndën e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	Institucioni ndjek një sërë procedurash për rekrutimin e personelit akademik. të cilat janë të reflektuara në disa akte ¹⁴⁰ . Njësia bazë bën planifikimin për staf akademik, kjo e bazuar dhe në numrin e studentëve të planifikuar, dhe më pas përcakton kriteret e punësimit të personelit akademik. Këto kriteret miratohen nga dekani, e më pas bëhen publike ¹⁴¹ e shpallen në faqen e internetit të Kolegjit www.wisdom.edu.al . Procedurat e rekrutimit që ndjek KU "Wisdom" hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore bashkëpunon me Njësia bazë për të

¹³⁹ Programi përfundimtar i provimit të programit profesional të studimeve të larta Asistent Social.

¹⁴⁰ Rregullore e KU Wisdom.

¹⁴¹ Rregullore e KU Wisdom.

	<p>ngritur një komision për vlerësimin e kandidaturave, i cili përbëhet nga drejtues të rektoratit, fakultetit, departamentit dhe titullarit të lëndës që do japë mësim. Gjithashtu, ngrihet dhe një komision ad-hoc i përbërë nga pedagogë dhe punonjës shkencorë efektiv.¹⁴² Miratimi i stafit akademik bëhet në fillim të çdo viti akademik në varësi të nevojave të njësisë bazë dhe në përputhje me numrin faktik të studentëve të regjistruar.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore angazhohet në mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin çdo vit akademik, të të dhënave të personelit akademik dhe administrativ.¹⁴³</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Detyrat e stafit akademik janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit, Fakultetit dhe Departamentit të Psikologjise si njësi bazë që përgjigjet direkt për përmbushjen e objektivave të programit të studimit me karakter profesional sipas rregullores së departamentit të psikologjise. Në këtë program studimi, për vitin akademik 18-19¹⁴⁴, janë angazhuar në total 9 pedagogë, prej të cilëve 6 PAE, me kualifikimin: 5 Dr., dhe 1 Msc. dhe 3 PAK, me kualifikimin 1 Prof. As. dhe 2 Msc. Ndërsa në vitin akademik 19-20¹⁴⁵, në këtë program studimi, janë angazhuar në total 10 pedagogë, prej të cilëve 7 PAE, me kualifikimin: 1 Prof. As., 4 Dr., dhe 2 Msc., dhe 3 PAK, me kualifikimin: 1 Prof. As., 1 Dr., dhe 1 Msc.</p>

¹⁴² Rregullore e KU Wisdom.

¹⁴³ Cv e stafit akademik.

¹⁴⁴ Të dhëna tabelore të kërkuara nga ASCAL viti akademik 2018-2019.

¹⁴⁵ Të dhëna tabelore të kërkuara nga ASCAL viti akademik 2019-2020.

Ngarkesa e stafit mësimor, bazuar në dokumentin e vënë në dispozicion nga IAL¹⁴⁶, varion për stafin PAE nga 45 orë deri në 75 orë mësimore në këtë program, dhe për stafin PAK është 75 orë. Në total, edhe në programet e tjera, ngarkesa e PAE është nga 405 deri në 450 orë dhe për stafin PAK është 75 deri në 225 orë. *Nga të dhënat e ngarkesës mësimore vihet re se në stafin PAK ekziston një rast kur norma është më e lartë se sa lejohet sipas udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018 e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.*

Bazuar në dokumentin e vënë në dispozicion nga KU "Wisdom" mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik, si dhe në të dhënat e dokumentit "*Personeli akademik dhe lëndët mësimore që zhvillojnë në departamentin e psikologjisë, viti akademik 2019-2020*"¹⁴⁷, 10 lëndë të këtij programi studimi mbulohen nga PAE dhe vetëm 4 lëndë mbulohen nga PAK¹⁴⁸. Vihet re se ka një mospërputhje tek ngarkesa mësimore e stafit akademik, tek dokumenti "*Personeli akademik dhe lëndët mësimore që zhvillojnë në departamentin e psikologjisë, viti akademik 2019-2020*"¹⁴⁹ me nr. prot 391/14 datë 02.10.2019 dhe dokumentit "*Planifikimi i leksioneve dhe seminareve për programin e studimeve profesionale të larta AS*" me nr. prot 391/18 datë 02.10.2019. GVJ i është referuar dokumentit "*Vendim për miratimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për programet e studimit "Master i shkencave" në "Psikologji shkollorë dhe edukimi", programin e studimit Bachelor në "Psikologji", programin e studimit "Asistent social"*", meqënëse kemi të bëjmë me një vendim, kurse në dokumentin "*Planifikimi i leksioneve dhe seminareve për programin e studimeve profesionale të larta AS*" kemi të bëjmë me një planifikim të orëve të stafit.

Ngarkesa mësimore në këtë program (AS) që mbulon stafi PAE është rreth 70 % dhe stafi PAK është deri në 30 %, duke bazuar llogaritjet në dokumentin e vendimit të

¹⁴⁶ Vendim për miratimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për programet e studimit "Master i shkencave" në "Psikologji shkollorë dhe edukimi"; programin e studimit Bachelor në "Psikologji", program studimi "Asistent social".

¹⁴⁷ Personeli akademik.

¹⁴⁸ Vendim për miratimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për programet e studimit "Master i shkencave" në "Psikologji shkollorë dhe edukimi"; programin e studimit Bachelor në "Psikologji", program studimi "asistent social".

¹⁴⁹ Personeli akademik.

	<p>miratimit të ngarkesës mësimore të stafit akademik për këtë program studimi¹⁵⁰.</p> <p>Infrastruktura në KU (Wisdom) ka krijuar kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Zyrat që kryenin funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Financa, Biblioteka, nuk kishin ambjente të veçanta, por ushtronin veprimtarinë e tyre të përditshme në të njëjtin ambient. Kjo u pa dhe u vëzhguar nga takimi i GVJ në IAL, ku punonjëset deklaruan se zyrat ishin së bashku me Bibliotekën. <i>Sugjerimi ynë në këtë rast do të ishte ndarja e zyrave sipas funksioneve dhe largimin e tyre nga hapësira e bibliotekës, e cila duhet të jetë një hapësirë që i dedikohet vetëm studentëve dhe stafit për hulumtime të ndryshme.</i> Institucioni ofron gjithashtu ambjente shlodhëse si bar/restorant, të cilat janë në dispozicion të stafit dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni dhe njësi bazë inkurajojnë përdorimin e formave të reja inovative në mësimdhënie përmes leksioneve të hapura me lektorë të huaj të ftuar në këtë institucion.¹⁵¹ Institucioni ka revistën shkencore KU “Wisdom”, në të cilën mundësohet publikimi i artikujve të ndryshëm shkencorë të stafit akademik. Përfshirja e një sërë aktivitete¹⁵² si studime rastesh, ese, detyra kursi ndihmojnë procesin e të nxënësve dhe lehtësojnë përvetësimin e materialit teorik më lehtësisht nga studentët e këtij programi profesional. <i>Sugjerohet nga GVJ të tregohet kujdes në përshtatjen e pjesës praktike me atë teorike lidhur kjo me nevojat e këtij profili profesional.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për

¹⁵⁰ Vendim për miratimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për programet e studimit “Master i shkencave” në “Psikologji shkollore dhe edukimi”; programin e studimit Bachelor në “Psikologji”, program studimi ‘Asistent social’.

¹⁵¹ Dokument nga trajnimi i stafit akademik për implementimin e metodave inovative të mësimdhënies.

¹⁵² Vendimi i departamentit për materialet didaktike.

formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Kolegji Universitar “Wisdom”, si një institucion me numër të vogël studentësh në këtë program studimi, e përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Mësimi në programin profesional “Asistent Social” zhvillohet në dy salla leksioni, 11 dhe 12 dhe një sallë laborator të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënies sipas Deklaratës të Administratorit të KU “Wisdom”.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore në KU “Wisdom” janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të tilla si tabela whiteboard dhe smartboard, wireless, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimit në kushte bashkëkohore. Laboratori i informatikës i cili është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, është i kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është i aksesueshëm për të gjithë studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Ky program studimi profesional zhvillohet në ambjentet e KU “Wisdom”, në të cilin vihen në dispozicion 2 salla leksionesh, përkatësisht salla 11 dhe 12 dhe një laborator përkatës sipas Deklaratës së Administratorit të KU “Wisdom”. Bazuar në specifikat e profilit profesional “Asistent Social” mjediset në dispozicion janë të favorshme për të realizuar qëllimet mësimore të lidhura me përvetësimin e dijeve dhe kompetencave profesionale të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Përveç sallave të leksioneve dhe ambjenteve të përbashkëta, KU “Wisdom” vë në dispozicion për këtë program një laborator të teknologjisë së informacionit, sipas Deklaratës së Administratorit të KU “Wisdom”. Ky laborator është i pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme teknologjike.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton,</p>	<p>Institucioni disponon një listë marrëveshesh me institucione</p>

me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	dhe OJF përkatëse për kryerjen e praktikave profesionale pranë tyre ¹⁵³ . Rregullorja e praktikës profesionale përcakton detyrat e departamentit, stafit akademik dhe studentëve. <i>Sikurse sugjeruar edhe gjatë vizitës në IAL, GVJ risugjeron lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione shtetërore si Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ti ardhur akoma më shumë në ndihmë studentëve të këtij programi profesional. Ky sugjerim u mirëkuptua dhe prit me pozitivitet gjatë bisedës në IAL.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	KU “Wisdom” disponon një Bibliotekë me një fond rreth 1271 tituj fizik dhe 3326 libra fizik, dhe rreth 150 tituj fizik janë për psikologjinë. Nga ana tjetër nëse i referohemi dokumentacionit mbi pasurimin e departamentit me bazën materiale didaktike në funksion të procesit mësimor që mban datën 11.10.2019 ¹⁵⁴ , janë planifikuar blerje e teksteve bazë të miratuara për studentët me vit botimi të pas 2010. <i>Ndërsa një dokument tjetër që mban datën 13.11.2019¹⁵⁵ mbi tekstet e propozuara nga departamenti për vitin akademik 2019-2020, përmban një listë me tekste, ku një pjesë e tyre janë me botime më të hershme dhe sipas mendimit të GVJ paraqesin probleme serioze në mënyrën e përkthimit në gjuhën shqipe.</i> Krahas literaturës fizike, institucioni përdor materiale ndihmëse dhe informuese për studentët si dhe forma e leksioneve në ppt. të cilat i vihen në dispozicion studenteve nëpërmjet faqes online ¹⁵⁶ . Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe aksesit të

¹⁵³ Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit.

¹⁵⁴ Vendimi i departamentit për materialet didaktike.

¹⁵⁵ Propozim nga departamenti i psikologjisë për zgjerimin e titujve në bibliotekë.

¹⁵⁶ Relacioni i bibliotekës për departamentin e psikologjisë.

	<p>bibliotekës online Pro-Quest si dhe përdorimit të katalogut elektronik Cobiss. Nett¹⁵⁷. <i>Sugjerohet nga ana e GVJ që institucioni të shtojë përpjekjet për tu abonuar në një revistë profesionale specifike për këtë program studimi, për t'ju ardhur në ndihmë studentëve. Orari i funksionimit të bibliotekës është 08:30-19:30, nga e Hëna në të Premte.</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Duke ju referuar listës së teksteve/periodikëve të shtuar së fundmi në funksion të këtij programi si dhe relacionit për bibliotekën e KU Wisdom mund të themi se biblioteka është e pajisur me një literaturë e cila përdoret më së shumti në disiplinën e psikologjisë, <i>por duke iu përshtatur edhe nevojave didaktike të këtij programi profesional, por ka mangësi në libra në shqip, të hartuar posaçërisht për këtë program studimi. Një pjesë e teksteve që përdoren në mbulimin e moduleve të veprimtarisë mësimore të këtij program mësimor, janë botime të para viteve 2010.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>KU “Wisdom” bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit, duke u bazuar tek Lista e teksteve/ periodikëve të shtuar së fundmi në funksion të këtij program, ku jepet lista e literaturës së shtuar gjatë vitit 2019-2020.</p> <p>KU “Wisdom” ka në funksion edhe bibliotekën online duke ju referuar Relacionit për bibliotekën e KU “Wisdom”. Çdo student mund të anëtarësohet falas në bibliotekën online, duke e shfrytëzuar atë në sallat e bibliotekës që janë pajisur me kompjutera, por edhe nga distanca.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>KU “Wisdom” ka lidhur një sërë marrëveshjesh institucionale¹⁵⁸ dhe përdor mjete të favorshme kompjuterike për realizimin teorik të këtij programi. Në funksion të nevojës për zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve në drejtim të përvetësimit të njohurive praktike, një sërë veprimtarish, duke ju referuar tabelës përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit, ndërmerren nga institucioni, si lehtësimi i përvojës praktike nga puna vullnetare në institucionet pritëse, monitorimi i tyre nga një supervisor në institucion, aktivitetet ekstra kurrikulare, lektorë të ftuar, etj.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon</p>	<p>Rregullat për shpërndarjen e burimeve dhe të ardhurave që</p>

¹⁵⁷ Kontrata e blerjes së Pro-Quest dhe e katalogut online.

¹⁵⁸ Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit.

<p>koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij përcaktohen nga Bordi i Administrimit, i cili është organi që mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit. Ky organ miraton edhe projekt buxhetin, duke ju referuar edhe projekt buxhetit 2019-2020. Në këtë buxhet parashikohen edhe si zë i veçantë shpenzimet kërkim zhvillim për stafin akademik.</p>			
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Duke ju referuar projekt buxhetit 2019-2020, burimet financiare të institucionit mbështeten kryesisht në pagesën e studentëve si dhe nga të ardhura nga projektet dhe nga kurset e ndryshme që zhvillojnë. <i>Duhet një nivel më i lartë i të ardhurave nga projektet ose burime të tjera në mënyrë që në rastin e ndonjë ulje të numrit të studentëve, të mos ndikojë në vazhdimin e programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.4



Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me</p>	<p>KU "Wisdom" ka hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, Vendimin e Senatit për kriteret e pranimit të studentëve, duke ju referuar vendimit nr 13 datë 12.03.2019, për kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor". Duke ju referuar programit për Asistent Social mungojnë këto kritere. Kriteri i pranimit në këtë program është të kesh mbaruar shkoillën e mesme të përgjithshme ose profesionale, duke ju referuar Analizës së departamentit përgjegjës mbi arritjet e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultatit të të nxëniet dhe aftësisimit profesional. <i>Megjithatë, duhet një miratim për</i></p>

<p>legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p><i>kriteret e pranimit nga senati si për çdo program tjetër, pavarësisht nivelit të këtyre kriterëve. Zhvillohen gjithashtu edhe ditët e informimit me maturatët ku ata njihen me hollësi si për stafin ashtu edhe për programet e ndryshme që zhvillon KU “Wisdom”¹⁵⁹.</i></p> <p>Duke ju referuar rregullores së programit të studimit profesional “Asistent Social” të cilat specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin e studentëve, nuk ka kriteret të veçanta për pranimin. Në lidhje me vlerësimin, duke ju referuar rregullores, bëhet publike mënyra e vlerësimit të studentëve, të cilat mund të jenë me shkrim, me gojë etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit, të përzgjedhjes së studentëve, bëhen publike nëpërmjet Ditëve të informimit të maturatëve nga stafi akademik ose nga informimi në faqen zyrtare të internetit www.wisdom.edu.al.</p> <p>Duke ju referuar dokumentit politika e marketingut, KU “Wisdom” bën edhe marketing si nëpërmjet shpërndarjeve të fletëpalosjeve, ashtu edhe në rrjetet sociale për të informuar publikun për të gjitha programet që zhvillohen tek KU “Wisdom”, përfshirë edhe programin profesional Asistent Social.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>KU “Wisdom” publikon në faqen tij të web-it www.wisdom.edu.al, informacion mbi kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve. Në faqen web jepen edhe orët e praktikave që zhvillohen në secilin vit studimi dhe pedagogun që e zhvillon këtë praktikë. Gjithashtu, pedagogët, në takim me studentët, japin informacion të hollësishëm se me cilat institucione zhvillohet veprimtaria praktike¹⁶⁰.</p> <p>Në faqen e internetit tek Guida e studentit jepet informacion i plotë për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit. Këto informacione jepen edhe gjatë Ditëve të informimit të maturatëve nga stafi akademik që zhvillohet çdo vit.</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale</p>	<p>KU “Wisdom” publikon në faqen tij të web-it www.wisdom.edu.al, informacion të detajuar për kohëzgjatjen e programit. Jepet informacion për orët e leksioneve dhe seminarit, si dhe orët e praktikave për çdo vit studimi, kreditet për secilën lëndë si dhe pedagogun përkatës.</p>

¹⁵⁹ Ditët e informimit e maturatëve nga stafi akademik

¹⁶⁰ Raport mbi takimet informuese me studentët e programit të studimeve të larta profesionale Asistent social.

<p>për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Gjithashtu, informacion mbi organigramën e fakultetit dhe strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e kolegjit.</p> <p>Në lidhje me orientimin e studentëve drejt tregut të punës, KU “Wisdom”, nëpërmjet miratimit të rregullores së burimeve njerëzore, këshillimit të karrierës dhe jetës studentore, ngarkon zyrën e burimeve njerëzore që të informojë studentët në çdo kohë për mundësinë e punësimit dhe orientimin drejt tregut të punës. Në faqen e saj në internet është bërë publik numri i personit të kontaktit për çdo pyetje që mund të kenë studentët për orientimin drejt tregut të punës. Ky orientim bëhet edhe gjatë takimeve informuese të pedagogëve me studentët e programit të studimeve të larta profesionale Asistent social¹⁶¹.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Duke përdorur platformën digjitale LMS studentët mund të marrin informacion për lëndët që do të zhvillojnë përgjatë semestrit dhe vitit akademik. Syllabuset e lëndëve mësimore përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, nivelin e detyrueshëm të frekuentimit të lëndës dhe literaturën bazë dhe atë të rekomanduar¹⁶².</p> <p>Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e Fakultetit dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e kolegjit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj.</p>
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sistemi përgjatë kohës së pandemisë ka dëshmuar më së miri efikasitetin e tij në realizimin konform rregulloreve të një sërë veprimtarish didaktiko-pedagogjike të domosdoshme për vijimësinë e procesit mësimor dhe ndërveprimin midis stafit akademik dhe studentëve. Sistemi LMS ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi i detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang</p>

¹⁶¹ Raport mbi takimet informuese me studentët e programit të studimeve të larta profesionale Asistent social.

¹⁶² Planin mësimor.

	<p>fakulteti ose kolegji. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale. Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës¹⁶³. Një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambientet e institucionit. Sipas RVB në faqen e internetit të KU “Wisdom” publikohen planet mësimore, por nga verifikimi i kryer, informacioni që ofrohet në faqen e internetit është i pakët.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>KU “Wisdom” ka miratuar Rregulloren e sekretarisë mësimore, ku theksohet se sekretaria mësimore, mban regjistrin bazë të studentëve, me të dhënat personale të tyre si dhe vlerësimet e marra gjatë viteve deri në diplomim. Ky regjistër plotësohet në mënyrë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Çdo student, në momentin e regjistrimit, i jepet një numër unik matricullimi që e shoqëron deri në marrjen e diplomës.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të informacionit të kolegjit është një program, i cili është në funksion të ruajtjes, administrimit dhe përpunimit të të dhënave të studentëve për të gjitha programet e studimit, të stafit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrative të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të</p>	<p>Informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit menaxhohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Sistemi elektronik LMS administron materialet e hedhura nga stafi akademik për lëndët dhe modulet e ndryshme, material shtesë, pikë dhe vlerësimet e studentëve në lëndë të</p>

¹⁶³ Plani mësimor.

angazhuar në realizimin e programit.	ndryshme. Ai informon studentët për pikët dhe notat on-line në kohë reale. Gjithashtu, ky sistem lejon ruajtjen e dokumentacionit dhe aktivitetet e personelit akademik. Ky sistem është në funksion kryesisht të procesit të mësimdhënies.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	KU "Wisdom" siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Platforma elektronike lehtëson komunikim interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve dhe studentëve në kohë reale. Sistemi i menaxhimit të informacionit të Kolegjit është një program, i cili është i aksesueshëm nga persona të autorizuar dhe gjithashtu mund të krijohen kushte për akses në informacione e dokumenta për studentët.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Në kushtet e pandemisë përdorimi i platformës on-line ka qenë domosdoshmëri. Të gjitha aktivitetet akademike janë realizuar përmes sistemit LMS. Sistemi LMS siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta; Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi i detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang Fakulteti ose Kolegji.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi i menaxhimit si dhe numri i vogël i pedagogëve me të cilët janë në kontakt çdo ditë organet drejtuese të institucionit siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale me ta. Ky sistem menaxhimi garanton monitorimin në kohë reale të një sërë aktivitetesh që lidhen me mbarëvajtjen e procesit akademik përmes statistikave numerike të gjeneruara prej tij. Në fund të çdo semestri gjenerohen statistika përshkruese në lidhje me aktivitetet akademike të ndërmarra nga stafi akademik. Këto të dhëna i vihen në dispozicion përgjegjësit të

	departamentit, organeve drejtuese dhe personave të tjerë përgjegjës për monitorimin e ecurisë së procesit mësimor.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	KU "Wisdom" publikon në shqip dhe anglisht, në faqen e tij të internetit, informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitete të ndryshme, etj. Në faqen zyrtare të Wisdom www.wisdom.edu.al paraqitet një informacion i plotë mbi filozofinë dhe misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin, organigramën, guidat për studentët e ardhshëm të Kolegjit Universitar si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. Përmes saj, por edhe rrjeteve sociale, kolegji promovon veprimtaritë e ndryshme me karakter akademik por edhe social-kulturor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret e pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që	Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR. Gjithashtu, këto kriteret janë miratuar edhe tek rregullorja e departamentit të psikologjisë, si dhe në Rregulloren e sekretarisë mësimore jepen kriteret e pranimit e vlerësimit të çdo studenti. Gjithashtu, në rregulloren e departamentit është miratuar edhe procedura e ndërprerjes së studimit nga studentët, për arsye vetjake ose familjare dhe rinisjen e tij në vitin

<p>janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>pasardhës.</p> <p>KU “Wisdom”, nëpërmjet departamentit përgjegjës, ka marrë vendimin për ngritjen e komisionit të transferimit të studimeve, vendim ky i miratuar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Komisioni ka detyrë të shqyrtojë të gjitha kërkesat drejtuar KU “Wisdom” për programin e studimit në të cilin do të transferohet.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e ndjekura nga UK “Wisdom” për pranimin e studentëve, si dhe procedurat e vlerësimit të studentëve që frekuentojnë këtë Kolegj, garantojnë barazinë e të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët që ndjekin këtë program.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni angazhohet përmes një sërë formash në promovimin dhe reklamimin e programeve të studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në KU “Wisdom”. Këto kritere i bëhen të ditura të interesuarve gjatë ditëve të informimit të maturatëve nga stafi akademik që zhvillohet çdo vit, nga informimi në faqen zyrtare të internetit www.wisdom.edu.al si dhe në rrjetet sociale.</p> <p>Për të gjithë të interesuarit për të vazhduar studimet në këtë program profesional dy vjeçar kriteret e përgjithshme/të veçanta lidhen me zotërimin e një diplome të shkollës së mesme dhe njohjen e gjuhës shqipe.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit, manualin orientues të studentëve, Rregulloren e njësisë kryesore/ bazë, si dhe rregulloren e sekretarisë mësimore. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online LMS. Studentët e interesuar mund të tërheqin pranë koordinatores së departamentit vërtetimin e notave, në të cilën gjenden të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive, sikurse dhe statusi për çdo lëndë. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në programet e çdo lënde. Meqënëse programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë</p>

	të mësimi, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në çdo lëndë.
Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet “Java e Orientimit”, e cila është e përvitshme në universitet. Gjatë kësaj jave realizohen takime, leksione të hapura për spjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të KU “Wisdom”. Në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit. Këto procedura janë të unifikuara për të gjithë universitetin, dhe janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të syllabusit të lëndës. Njësia bazë përmes strukturave të saj informon studentët e programit profesional përgjatë fundit të semestrit të parë dhe fillimit të semestrit të dytë në lidhje me Provimin e Përgjithshëm Përfundimtar (PPP) ¹⁶⁴ . Për provimin e përgjithshëm përfundimtar jepet një udhëzim në lidhje me tematikat e përfshira. Fazat kohore të mbrojtjes së diplomës përmes provimit me shkrim bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e këtyre procedurave që lidhen me provimin e përgjithshëm përfundimtar e realizon koordinatori dhe drejtuesi i njësisë bazë.
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në fillim të çdo viti akademik kolegji organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky kolegji. Këto takime të hapura janë zhvilluar edhe në shkolla të mesme por edhe duke i ftuar maturantët në ambjentet e kolegjit. Gjithashtu kolegji përgatit udhëzime, fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij. Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi ¹⁶⁵ . Në lidhje me tërheqjen e studentëve të rinj, çdo pranverë, KU “Wisdom” organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë dhe studentë, të cilët vizitojnë shkolla të mesme në qytete të ndryshme të vendit për t’u bërë të njohur maturantëve programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t’i ndihmuar ata në vendimarrje. Veprimtaritë “Universiteti me dyer të hapura” janë veprimtari që i ftojnë maturantët të vizitojnë institucionin dhe të ndjekin orë leksioni të hapura si dhe “Java e Orientimit” për studentët e vitit të parë para fillimit të vitit akademik ndihmon studentët të marrin informacionin

¹⁶⁴ Model i diplomës profesionale Asistent Social.

¹⁶⁵ Fletëpalosje e KU Wisdom.

	e nevojshëm. Përgjatë javëve të regjistrimit, KU "Wisdom" vë në dispozicion të maturantëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta, pedagogë sipas fakulteteve. Ata japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve ¹⁶⁶ .			
Shkalla e përmbasjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	Duke ju referuar rregullores së sekretarisë mësimore, informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencial, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë ku ata aplikojnë. Në dispozicion të studentëve të programeve të studimit aksesimi tek informacioni mbi kurrikulën dhe programin e studimit mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit. Gjithashtu duke përdorur platformën digjitale studentët mund të marrin informacion për lëndët që do të zhvillojnë përgjatë semestrit dhe vitit akademik. Syllabuset e lëndëve mësimore përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, nivelin e detyrueshëm të frekuentimit të lëndës dhe literaturën bazë dhe atë të rekomanduar ¹⁶⁷ . Pedagogët gjithashtu e japin këtë informacion në fillim të çdo semestri për secilën prej lëndës apo modulit që japin.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit	Institucioni informon studentët potencialë edhe ata që regjistrohen mbi praktikat mësimore që do zhvillohen gjatë këtij programi si dhe institucionet ku do të zhvillohen këto

¹⁶⁶ Ditët e informimit me maturantët nga stafi akademik.

¹⁶⁷ Piani mësimor.

<p>të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>praktika. Lehtësimi i procesit të orientimit të studentëve mbi praktikat profesionale favorizohet edhe nëpërmjet bashkëpunimit të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore dhe njësisë kryesore/ bazë. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me organizata publike dhe të biznesit¹⁶⁸. Në lidhjet me ecurinë e marrëveshjeve me institucione të ndryshme për të zhvilluar praktikat mësimore, Departamenti i Psikologjisë ku përfshihet edhe programi “Asistent social”, ka bërë një raport për zbatueshmërinë e këtyre marrëveshjeve gjatë viteve 2017-2020.</p> <p>Duke ju referuar rregullores së burimeve njerëzore, këshillimit të karrierës dhe jetës studentore, zyra e burimeve njerëzore informon studentët në çdo kohë, për mundësinë e punësimit dhe orientimin drejt tregut të punës. Kjo zyrë ka miratuar edhe personin e kontaktit me studentët për orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Ky orientim bëhet edhe gjatë takimeve informuese të pedagogëve me studentët e programit të studimeve të larta profesionale Asistent social¹⁶⁹.</p>
<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e KU “Wisdom” lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si sallat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Në funksion të nevojave të studentëve janë edhe vetë pedagogët e moduleve/lëndëve, koordinatorja e programit të studimit por edhe zyra e këshillimit të karrierës.</p>
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Përmes platformës on-line, institucioni ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Ky sistem ka rezultuar i dobishëm veçanërisht përgjatë këtij viti akademik si pasojë e pandemisë Covid 19, ku aksesit ka qenë gati 100 % nga studentët . Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët.</p>

¹⁶⁸ Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit.

¹⁶⁹ Raport mbi takimet informuese me studentët e programit të studimeve të larta profesionale Asistent social.

	Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale. Gjatë intervistës me stafin akademik, por edhe nga GVB na u referua se çdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorin e teknologjisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	Duke iu referuar këtij kriteri rezultojnë vlerësime të vështirë vlerësimi i përmbushjes ose jo, pasi ky është brezi i parë i studentëve në këtë program studimi, të cilët pritet të diplomohen në këtë vit akademik. Por, për programet e tjera të studimit, sipas RVB, sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve ¹⁷⁰ .
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore, nëpërmjet regjistrave përkatës, mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit për çdo vit akademik ¹⁷¹ . Referuar statistikave në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi profesional, të marra në sekretarinë mësimore gjatë vizitës në IAL në vitin akademik 2018-2019, janë regjistruar për herë të parë 7 studentë, prej të cilëve kanë kaluar në vitin e dytë 5 studentë, 1 student është ç' regjistruar, ndërsa 1 është përsëritës. Ndërsa në vitin akademik 2019-2020 janë regjistruar për herë të parë 12 studentë.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të	Sekretaria mësimore regjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në

¹⁷⁰ Rregullore e sekretarisë mësimore.

¹⁷¹ Rregullore e sekretarisë mësimore.

<p>studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>diplomimin e tyre. Statistikat për ecurinë e studentëve janë të pasqyruara përgjatë të dy viteve dhe fokusohen në të dhëna mbi numrin e studentëve sipas viteve të studimit, nota mesatare e hyrjes dhe e daljes, studentë të transferuar sipas viteve, edhe pse për këtë program studimi profesional nuk rezulton asnjë student i transferuar dhe vetëm një student i ç'rregjistruar. Sistemi i menaxhimit të informacionit ofron funksionalitetin e nevojshëm për ecurinë e studentëve përgjatë zhvillimit të programit të studimit, nga regjistrimi deri në përfundim. Sekretaria mësimore po punon për krijimin e një database për studentët e këtij programi, duke pasur parasysh që ende nuk janë diplomuar studentët e parë.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë mësimore¹⁷². Zyra e regjistrimit të studentëve që realizohet përmes sekretarisë mësimore është struktura e posaçme që merret me ruajtje dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre në drejtim të menaxhimit të rekordeve të studentëve e realizojnë edhe përmes sistemit informatik elektronik. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e KU "Wisdom". Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit si deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, dëftesë dhe listë notash e noterizuar e shkollës së mesme, kontrata e studentit. Këto të dhëna vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin e brendshëm të informacionit dhe regjistrat për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të saktë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve. Ndërkohë që nuk është llogaritur ende mesatarja e notave në përfundim të studimeve (meqenëse nuk ka mbaruar ende viti akademik). Referuar raportit të departamentit¹⁷³ mbi punën e tij për vitin akademik 2019-2020, ka një qëndrim pozitiv mbi ecurinë e këtij programi profesional studimi ku numri i studentëve në vitin e parë të hapjes 2018-2019, ka qenë relativisht i vogël 7 studentë,</p>

¹⁷² Rregullore e sekretarisë mësimore.

¹⁷³ Analizë e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësisimit profesional.

	ndërsa këtë vit akademik 2019-2020 është 12 studentë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Nëpërmjet Statutit të KU "Wisdom" ¹⁷⁴ , rregullore së Fakultetit dhe rregullore së Departamentit të Psikologjisë ¹⁷⁵ institucioni parashikon angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si këshillin e studentëve, i cili është grupim i studentëve dhe përzgjedh përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të KU "Wisdom". Përfshirja e studentëve në një sërë strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u siguron të drejtën për të qenë pjesë aktive në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese të KU "Wisdom".
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentat e vëna në dispozicion nga KU "Wisdom", si Statuti i KU Wisdom, Rregullore e njësisë bazë kryesore, vendimi i Senatit për emërimin e anëtarëve të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Vendimi për hapjen e programit të studimit profesionale Asistent Social, GVJ konfirmoi se studentët ishin realisht të përfshirë në këshillim dhe vendimmarrje. Studentët kishin përfaqësuesin e tyre si në Senatin e kolegjit, në Këshillin e Etikës dhe në zyrën e NJBSC. Sipas Statutit ¹⁷⁶ ata kanë formuar edhe Këshillin Studentor. Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve. Ata janë pjesë aktive e mbledhjeve të senatit

¹⁷⁴ Statuti i KU Wisdom.

¹⁷⁵ Rregullore e njësisë bazë kryesore.

¹⁷⁶ Statuti i KU Wisdom.

	<p>akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari. Studentët janë të përfshirë në grupime studentore siç është Klubi Ligji dhe Demokracia, Klubi i Sipërmarrësve Studentorë, Klubi Jeta Studentore dhe Klubi i Vullnetarëve në Shqipëri. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes plotësimit të pyetësorit “Për vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies” dhe përmes fokus grupeve¹⁷⁷.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi është hartuar dhe zbatohet duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në harmoni dhe me udhëzimet dhe vendimet e MASR. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesa e shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra (afërsisht 30 ECTS për semestër), ose 60 ECTS për çdo vit studimi referuar Planit Mësimor. Duke ju referuar Rregullores së njësisë kryesore/ bazë, si dhe nga rregulloresë së sekretarisë mësimore, si dhe vendimit të njësisë përgjegjëse për miratimin e komisionit të transferimeve dhe ekuivalentimeve, konstatohet se KU “Wisdom” ka rregullore dhe procedura që lehtësojnë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të realizuara nga studenti.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimmarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtpërdrejtë në këtë drejtim shërben edhe pyetësori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri¹⁷⁸. <i>GVJ konstatoi se pyetjet në pyetësor lidheshin më shumë me performancën e pedagogut se sa me programin e studimit dhe në fakt nuk përbën një burim informacioni në këtë drejtim.</i> Por gjithsesi, duke pasur që programi ka pak kohë që është aktiv, do të duhet të presim për të parë vijimësinë e tij dhe mënyrën se si ky program do të synojë të përmirësojë vetveten në përputhje dhe me nevojat e tregut të punës, të cilat janë në ndryshim të vazhdueshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u</p>	<p>Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe</p>

¹⁷⁷ Pyetësori i studentëve.

¹⁷⁸ Pyetësori i studentëve.

mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Shoqërore, rregullorja e Departamentit të Psikologjisë dhe rregullorja e programit të studimit profesional “Asistent Social” ¹⁷⁹ mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimit. Duke ju referuar rregullores së Departamentit të Psikologjisë studentët kanë të drejtë të ankohen për rezultatin përfundimtar të vlerësimit, brenda 3 ditëve nga marrja e dijeni të vlerësimit. Kjo ankesë i dorëzohet dekanit, i cili ja përcjell departamentit përkatës. Përgjegjësi i departamentit ngrë një komision ad-hoc që bënë verifikimin e pretendimeve të ngritura nga studenti dhe bënë vlerësimin përfundimtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbimin të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	KU “Wisdom” ka ngritur Zyrën e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, e cila kryen disa funksione, përfshirë edhe atë të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve ¹⁸⁰ . Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Nga vizita në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se është një zyrë që kryen funksionet e të tre zyrave, për shkak të numrit relativisht të ulët të studentëve që ka kolegji. <i>Sugjerohet që këto funksione të kryhen nga zyra të veçanta, për të realizuar pritshmëritë që KU “Wisdom” ka për të ardhmen.</i>
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe	Duke ju referuar Rregullores së Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, institucioni ka caktuar një person kontakti i cili i informon, këshillon studentët. Personi i kontaktit është bërë publik edhe në faqen zyrtare në internet të institucionit. Në shërbim

¹⁷⁹ Rregullore e njësisë bazë kryesore.

¹⁸⁰ Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore.

<p>ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>të studentëve është dhe funksionon gjithashtu koordinatori i programit, që synon monitorimin e problematikave që lidhen me procesin mësimor dhe çështje të tjera të cilat ngrihen nga studentët¹⁸¹.</p>			
<p>Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Karrierës, pjesë e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit. Kjo zyrë orienton dhe këshillon studentët për praktikat mësimore, të cilat zhvillohen në institucione të ndryshme. Duke ju referuar vendimit për miratimin e udhëheqjes së praktikave profesionale të studentëve të vitit të 1 dhe 2 në programin e studimit Asistent Social, pedagogu përgjegjës, informon dhe i orienton studentët për praktikat që do të zhvillojnë gjatë këtij programi.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Një nga detyrat e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është edhe përpilimi, plotësimi dhe përditësimi i skedës së punësimit për studentët e nivelit Bachelor, Master Profesional dhe Master Shkencor, përfshirë këtu edhe studentët e programeve profesionale¹⁸². Megjithatë, duke qenë se ky program është i ri dhe akoma nuk ka dalë brezi i parë i asistentëve social, është e parakohshme të kërkohen evidenca mbi vijimin e punësimit të studentëve pas përfundimit të programit. Ky aspekt duhet parë në vijimësi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

¹⁸¹ Vendimi për emërimin e koordinorit të programit të studimit, detyrat e koordinorit.

¹⁸² Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore.

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Asistent Social”, ofruar nga Kolegji Universitar “Wisdom”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Profili profesional i përgjigjet nevojave të tregut për profesionist të kualifikuar të cilët ofrojnë shërbimin e tyre për moshën e tretë dhe kategoritë e tjera me nevoja të veçanta.
2. Digjitalizimi i sistemit të të dhënave në ndihmë të infrastrukturës në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
3. Nxitja e shkëmbimeve në arsimin e lartë për stafin akademik përmes Erasmus +.
4. Përfshirja e stafit akademik në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit.
5. Përfshirja e studentit në vlerësimet periodike të formave të mësimdhënies dhe të stafit akademik.
6. Infrastruktura fizike në funksion të realizimit të procesit mësimor.
7. Abonimi në bibliotekën online Pro Quest dhe COBISS Net.
8. Zyra e këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit ka një rol ndihmues në drejtim të mbështetjes së studentit.
9. Klima pozitive e bashkëpunimit dhe punës midis stafit dhe studentëve.

Pikat e dobëta:

1. Boshllëqe në krijimin e një fondi të literaturës të lidhur specifikisht me profilin e këtij programi studimi që lejon pedagogët dhe studentët të kuptojnë në mënyrë më të qartë dhe të plotë linjën e vërtetë që duhet t'i japin prioritet për të formësuar një profesionist i cili të qëndrojë brenda profilit profesional të “Asistentit Social”.
2. Mungesa e një plani të organizuar në lidhje me mënyrën se si përzgjidhen institucionet e mundshme për praktikën profesionale, me qëllim që të jenë në linjë me kualifikimin dhe detyrat e punës së një asistenti social.
3. Pamundësia e supervizimit të studentëve të programit profesional “Asistent Social” nga një profesionist në terren që mbulon pikërisht rolin e asistentit social, vështirëson të kuptuarit qartë të rolit dhe të njohjes së profilit të tyre profesional.
4. Literatura e cunguar në gjuhën shqipe dhe të huaj për mbulimin e lëndëve dhe moduleve të programit të studimit e cila është hartuar dhe përdoret kryesisht për dy profile të tjera si Psikologjia dhe Puna Sociale, por pa një fokus të qartë mbi rolin e asistentit social.
5. Mospërfshirja e studentëve dhe pedagogëve të programit të studimit në procesin e komunikimit dhe diskutimit të hapur të rezultateve të vlerësimit të programit të studimit.
6. Mungesa e një promovimi adekuat të këtij programi profesional me qëllim që të njihet dhe të kuptohet qartë si profesion nga të interesuarit.
7. Mungesë e lobbimit të institucionit në instancat shtetërore dhe strukturat e politikave sociale me qëllim njohjen e këtij profili profesional dhe përfshirja në listën e profesioneve të njohura nga shteti.

8. Mjedisi fizik i bibliotekës i cili kryente njëherësh funksionin e bibliotekës, por dhe shërbente si zyrë për disa njësi të tjera të stafit administrativ.


Rekomandime:

1. Përfshirja e stafit akademik në trajnime të vazhdueshme mbi profilin e ri "Asistent Social".
2. Përshtatje më e mirë e protokollit të realizimit të praktikës profesionale duke i atashuar studentët më së shumti në institucione të cilat i përshtaten këtij profili si: azilet për moshën e tretë, qendrat komunitare rezidenciale, dhe institucionet e përkujdesjes dhe përkrahjes sociale.
3. Rritja e mundësive të përfshirjes së stafit akademik në mobilitete jashtë vendit në struktura të specializuara për këtë profil profesional me qëllim që të përmirësojnë kompetencat profesionale dhe qartësojnë rolin e asistentit social.
4. Rritja e numrit të burimeve të literaturës për lëndët e programit të studimit në gjuhën shqipe dhe të huaj, me burime të pesë viteve të fundit.
5. Përfshirja e studentëve në procesin e komunikimit të rezultateve të vlerësimit të programit të studimit, të mësimdhënies dhe vlerësimit të brendshëm.
6. Të shfrytëzohen marrëveshjet e bashkëpunimit në drejtim të praktikës profesionale.
7. Përfshirja e studentëve të programit të studimit në punë vullnetare pranë qendrave të specializuara për profilin e tyre, me qëllim motivimin e tyre në drejtim të rritjes së përpjekjeve për zhvillimin e dijeve dhe njohurive mbi fushën e studimit.
8. Krijimi i një mjedisi me hapësira më të mëdha i cili të ketë një funksion, atë të bibliotekës, duke zhvendosur zyrat që ndanin këtë hapësirë në mjedise më të përshtatshme.
9. Shfrytëzimi i qendrës së shërbimeve psikologjike "Urtësia", si një formë e mirë për të lehtësuar përvojat e praktikës profesionale.
10. Shfrytëzim më i mirë i të dhënave që departamenti nxjerr nga analiza e punës së pedagogut të lëndës në fund të çdo semestri.
11. Shfrytëzim më i mirë i bashkëpunimit me bordin e punës, me qëllim mbështetjen e studentëve drejt punësimit brenda fushës së studimit.

Conclusions of the evaluation of the study program with professional character "Social Assistant", offered by University College "Wisdom"

Strengths and affirmations:

1. The professional profile responds to the needs of the market for qualified professionals who offer their service to the elderly and other categories with special needs.
2. Elaboration of the data system in aid of instruction in teaching and learning.
3. Promoting exchanges in higher education for academic staff through Erasmus +.
4. Involvement of academic staff in national and international projects of the institution.



5. Involvement of the student in periodic assessments of teaching forms and academic staff.
6. Physical infrastructure in function of the realism of the learning process.
7. Subscribe to the Pro Quest and COBISS Net online library.
8. The Office of Career Counseling and Student Care has a supportive and significant role in supporting the student.
9. Positive climate of cooperation and work between staff and students.

Weaknesses:

1. The gaps in the creation of a literature fund specifically related to the profile of this study program that allows pedagogues and students to understand more clearly and fully the real lines that should give priority to the formation of a profession who stays within the professional profile of the "social assistant".
2. Lack of an organized plan on how to select possible institutions for professional practice, in order to be in line with the qualifications and tasks of a social assistance.
3. The impossibility of supervising the students of the professional program "Social Assistant" by a professional in the field who covers exactly the role of the social assistant, makes it difficult to clearly understand the role and recognition of their professional profile.
4. The truncated literature in Albanian and foreign language for the coverage of the subjects and modules of the study program which has been drafted and is used mainly for two other profiles such as Psychology and Social Work, but without a clear focus on the role of the social assistant.
5. Involvement of students and pedagogues of the study program in the process of communication and open discussion of the results of the evaluation of the study program.
6. Lack of adequate promotion of this professional program in order to be clearly recognized and understood as a profession by those interested.
7. Lack of lobbying of the institution in state instances and social policy structures in order to recognize this professional profile and inclusion in the list of professions recognized by the state.
8. The physical environment of the library, which at the same time performed the function of a library but also served as an office for the administrative staff.

Recommendations:

1. Involvement of academic staff in continuous training on the new profile "Social Assistant".
2. Better adaptation of the professional practice implementation protocol by attaching students mostly to institutions that suit this profile such as asylum for the elderly, residential community centers, and social care and support institutions.



3. Increasing the opportunities for the involvement of academic staff in mobility abroad in specialized structures for this professional profile in order to improve professional competencies and clarify the role of the social assistant.
4. Increasing the number of literature sources for the subjects of the study program in Albanian and foreign language, with sources of the last five years.
5. Involvement of students in the process of communicating the results of the evaluation of the study program, teaching and internal evaluation.
6. Utilize cooperation agreements in terms of professional practice.
7. Involvement of students of the study program in volunteer work near the specialized centers for their profile, in order to motivate them towards increasing efforts to develop knowledge and knowledge in the field of study.
8. Creating a more spacious environment that has one function, that of the library, relocating offices that share this space in more appropriate environments.
9. Utilization of the psychological services center "Urtësia", as a good way to facilitate the experiences of professional practice.
10. Better use of data that the department derives from the analysis of the work of the subject lecturer at the end of each semester.
11. Better use of cooperation with the work board, in order to support students towards employment within the field of study.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Phd. Eglantina Dervishi
2. Dr. Darina Çoni (Kacollja)



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit me karakter profesional

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Naë përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X